



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 19 DHE 24 SHKURT 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 19. I 24. FEBRUARA 2016. GODINE**

**SHKURT - FEBRUAR
2016**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-068,
5. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e rehabilitimit të rrugës hekurudhore 10,
6. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2014 për projektin e Huas,
7. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë Kosovë - UniCredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në QKUK,
8. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e Projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit,
9. Votimi i propozim-amendamentit nr. 25 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i riproceduar nga Qeveria e Republikës së Kosovës,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuessve dhe punëdhënësve,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet strategjike në Republikën e Kosovës,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kundërvajtje,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit,
16. Shqyrtimi i propozim-Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij,
17. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për standardizimin,
18. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë,
19. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Bujqësor,
20. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2016,
21. Zgjedhja e një (1) anëtarë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe
22. Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Dnevni red

1. Izjašnjavanje van dnevnog reda,
2. Poslanička/parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prošle sednice,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama Zakona br. 04/L-042 o javnim nabavkama Republike Kosova, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L237 i Zakonom br. 05/L-068,
5. Glasanje o Nacrta zakona o ratifikaciji Sporazuma o pozajmici između Vlade Republike Kosova i Evropske banke za obnovu i razvoj za projekat rehabilitacije kosovske železnice¹⁰,
6. Glasanje o Nacrta zakona o ratifikaciji Sporazuma o pozajmici između Vlada Republike Kosova i Savezne Republike nemačke o finansijskoj saradnji 2014 za projekat pozajmice,
7. Glasanje o Nacrta zakona o ratifikaciji Sporazuma o kreditu Kosova - UniCredit Bank Austria AG za finansiranje projekta modernizacije usluga invazivne kardiologije UKCK,
8. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji sporazuma za financiranje, između Republike Kosova i Međunarodne asocijacije za razvoj, za realizaciju Projekta za poboljšanje sistema obrazovanja,
9. Glasanje o Predlogu amandmana br. 25 na Ustav Republike Kosova, koji je nanovo procesuirala Vlada Republike Kosova,
10. Prvo razmatranje Nacrta zakona o visokom obrazovanju u Republici Kosova,
11. Prvo razmatranje Nacrta zakona o registraciji i pružanju usluga i mera upošljavanja nezaposlenih, onih koji traže posao i poslodavaca,
12. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama Zakona br. 03/L-019 o osposobljavanju, stručnoj prekvalifikaciji i upošljavanju osoba sa ograničenim sposobnostima,
13. Prvo razmatranje Nacrta zakona o strateškim investicijama u Republici Kosova,
14. Prvo razmatranje Nacrta zakona o prekršajima,
15. Prvo razmatranje Nacrta zakona o sponzorstvu i donacijama u oblasti kulture, omladine i sporta,
16. Razmatranje Predloga pravilnika o izbornim postupcima i razrešenju narodnog advokata i njegovih zamenika,
17. Razmatranje izveštaja Komisije za Privredni razvoj, infrastrukturu, trgovinu i industriju o kontroli provedbe Zakona o standardizaciji,
18. Razmatranje izveštaja Komisije za unutrašnje poslove, bezbednost i nadgledanje KBS-a o kontroli provedbe Zakona o policiji,
19. Razmatranje izveštaja Komisije za poljoprivredu, šumarstvo, životnu sredinu i prostorno planiranje o kontroli provedbe Zakona o poljoprivrednom inspektoratu,
20. Razmatranje preporuke Komisije za budžet i finansije o zahtevu Kosovskog fonda penzijskih ušteda za odobravanje godišnje takse za 2016. god.,
21. Izbor jednog (1) člana Kosovskog sudskog saveta,
22. Izbor dvojice (2) članova Odbora RTK-a.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Edhe pse jashtë rregullit, ju lutem lejojeni të flasë. Kryetari i Lëvizjes “Vetëvendosje”, deputeti Visar Ymeri, e ka fjalën. Urdhëro, Visar!

VISAR YMERI: Qytetarë të nderuar të Republikës së Kosovës, Siç e keni parë të gjithë, ka një lëvizje shoqërore tashmë jashtë, që insiston në largimin e këtij regjimi. Një lëvizje e qytetarëve sovranë, të cilët janë pa bishta. Ata brohorasin në mbrojtje të Republikës, e nuk ulërijnë.

205 mijë qytetarë të peticionit, qindra mijëra qytetarë të protestave, shoqëria civile, intelektualët, i kanë shpallur “Zajednicën” dhe Demarkacionin të vdekura.

Gjykata Kushtetuese e ka shpallur këtë regjim antikushtetutes.

Ju qytetarë të Republikës së Kosovës ia keni hequr maskën këtij regjimi mashtruesish, e keni shpallur atë jolegjitim, antidemokratik, antirepublikë.

Prandaj, regjimin Mustafa-Thaçi nuk do ta lejojmë të sillet si Qeveri e Republikës së Kosovës.

Ky regjim sundimtarësh po mundohet ta mbajë veten dhunshëm në këto karrige.

Po mundohet dhunshëm ta mbajë shtetin të kapur.

Po mundohet dhunshëm të mbajë seanca për ta thelluar kapjen e shtetit, për ta zgjeruar atë deri në majën e tij. Pra, deri në Presidencë.

Deputetët po i kidnapojnë, po i arrestojnë e mbajnë burgjeve. Aktivistët po i përndjekin e mbajnë burgjeve, po i rrahin nëpër maune e stacione policore.

I fusin armët e zjarrit e njësitë elite të Policisë në zyrat e opozitës. E keqpërdorin atë duke e ndërsyer kundër popullit. Fshihen prapa Policisë. E gjuajnë gurin dhe nuk kanë guxim ta tregojnë dorën.

Kjo Qeveri nuk ka qenë kurrë. Ka filluar si regjim dhe po përfundon si regjim. Por, ama ky është fundi i saj.

Këtë duhet ta kuptojnë Isa dhe Hashimi. Këtë duhet ta kuptoni të gjithë ju këtu në sallë. Sepse, populli e ka kuptuar këtë shumë më herët se ju.

Populli tashmë ka vendosur - regjimi Mustafa-Thaçi nuk është më.

KRYETARI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që ta filloj seancën. E kam edhe një deklaratë për ta lexuar. Ju kisha lutur për vëmendje!

I nderuar kryeministër,
I nderuar zëvendëskryeministra edhe ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e Sesionit pranveror të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2016.

Rendin e ditës, bashkë me materialet, e keni marrë.

Para se të filloj me rendin e ditës, ju kisha lutur për shkak të një situate e cila ka ndodhur ndërkohë, dy nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës pa të drejtë janë dënuar nga gjykata të huaja. Do të lexoj një deklaratë, të cilën dëshiroj nga ju që ta nxjerrim bashkërisht.

Në bazë të nenit 65, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2016, miraton këtë d e k l a r a t ë:

(Opozita hedh gaz lotsjellës në sallën e mbledhjeve plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.)

Opozitë! Nuk është dinjitoze, megjithatë le të mbetet në ndërgjegjen tuaj, kjo çfarë po bëni ju. Është cenim penal.

I kisha lutur deputetët të mos i cenojnë organet e kontrollit, të cilat janë për të mirën e të gjithëve ne bashkërisht.

Ju kisha lutur për qetësi!

D E K L A R A T Ë

Kuvendi i Republikës së Kosovës shpreh shqetësimin për farsën e gjykatave të Serbisë për dënimin e ish-ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Për Kuvendin e Republikës së Kosovës dënimet e tilla janë politike dhe ndikojnë direkt edhe në raportet Kosovë - Serbi.

Kuvendi i Republikës së Kosovës këto akte i konsideron pa vlerë juridike.

Kuvendi i Republikës së Kosovës i fton autoritetet ndërkombëtare që të ndikojnë në institucionet ndërkombëtare, si Interpol e Europol e të tjera, që ta refuzojnë çdo kërkesë të autoriteteve të Serbisë dhe t'i kuptojnë këto akte politike si pa efekt juridik.

Kuvendi i Republikës së Kosovës do të angazhohet direkt dhe kërkon nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare që të ndërmarrin veprime për anulimin e këtyre akteve dhe akteve tjera akuzuese fiktive dhe politike.

Ju kisha lutur, të votohet deklarata.

E kisha lutur Administratën për votim. Kush është për deklaratën? Ngriheni dorën, ju lutem! Duhet qëndruar, se duhet treguar vendosmëri pak. Në ndërgjegjen tuaj opozitë kjo çfarë bëni.

Dëgjo! Fisnik, dil jashtë të lutem! Fisnik, mos e turpëro as veten, as ne! Dil jashtë!

Administrata, të lutem, numrin e deputetëve dhe ngritjen e dorës dhe ma jep konfirmimin nëse kaloi deklarata. Ju lutem! Shpejt, ju lutem, ta konstatoj.

Të nderuar deputetë,
Më vjen keq, por kaloni sa më larg tymit. Largohuni deputetë, një pjesë. Ta përfundojmë deklaratën, të tregojmë vendosmëri. “Vetëvendosja” është dashur ta votojë këtë deklaratë, ashtu siç është dashur t’i votojë procedurat për liberalizim të vizave.

Sa veta janë, Administrata? Ma jepni konstatimin, ju lutem!

Konstatoj se me 79 vota për miratohet kjo deklaratë e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ju kisha lutur pauzë! I kemi vetëm pesë minuta, pastaj e vazhdojmë prapë seancën. Vazhdojmë pastaj me rendin e ditës menjëherë.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Para se të fillojmë me rendin e ditës, ju njoftoj se me kërkesë të kryetarit të Kuvendit, e me vendim të Presidencës së Republikës është bërë zëvendësimi i dy ish-deputetëve në Kuvendin e republikës së Kosovës, si në vijim:

Zoti Abdyl Ymeri, kandidat i subjektit politik PDK-PDLB-PSHDK-PKK e zëvendëson ish-deputetin Latif Gashi.

Zoti Bislim Zogaj, kandidat i subjektit politik PDK-PDLB-PSHDK-PKK e zëvendëson ish-deputetin Rustem Mustafa.

Ju njoftoj se betimi i deputetëve është një veprim i paraparë me Kushtetutë dhe me Rregulloren e Kuvendit. Tekstin e deklaratës së betimit e ka secili deputet para vetes dhe e njëjta duhet të nënshkruhet personalisht.

Deputetë, merreni tekstin e deklaratës dhe nënshkruajeni. Nënshkruani dhe ju dëshiroj mirëseardhje! Urime pozita juaj si përfaqësues i popullit. Faleminderit!

(Opozita hedh gaz lotsjellës në sallën e mbledhjeve plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.)

Ju kisha lutur ajrosjen, në qoftë se ka mundësi. Mos e shtyni kujdestarinë! Fisnik, je duke u sjellë shumë keq. Nuk është me mish kjo punë. Mos i shtyj! Ata janë duke e bërë veç punën e vet. Ju kisha lutur, të qetë!

I kemi 60 milionë të cilët sot duhet të aprovohen nga ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare. E kemi liberalizimin e vizave.

I kisha lutur deputetët, nëse mund, le të qëndrojnë në sallë. Spostohuni pak, do të qëndrojmë në sallë, në qoftë se mundni. Do ta ndalim edhe këtë pjesë.

Më vjen keq, por kush është më dobët prej shëndetit le të largohet, derisa të largohet nga ventilatorët.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në 5 minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në tre minuta.

Asnjë deputet nuk është paraqitur për deklarime jashtë rendit të ditës.

2. Koha për pyetje parlamentare

Asnjë deputet nuk ka parashtruar pyetje parlamentare.

3. Miratimi i procesverbalit nga seancat e mëparshme

E kisha lutur Administratën, a kemi kuorum?

Të nderuar deputetë,

A keni vërejtje në procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 14 dhjetor 2015, në orën 10:00, dhe 14 dhjetor 2015, në orën 22:00?

(Opozita hedh gaz lotsjellës në sallën e mbledhjeve plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.)

A ka vërejtje dikush? Kjo pikë mbetet. Pesë minuta pauzë, pastaj vazhdojmë menjëherë. Ventilatorët le të punojnë, pesë minuta pauzë! Vazhdojmë menjëherë.

Gjuaji edhe dy, se pak është një!

(Reagime nga salla)

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Ne do ta vazhdojmë seancën për hir të interesit qytetar. Ka të bëjë me liberalizimin e vizave, një projektligj i cili pritet të miratohet sot edhe me 60 milionë e 800 mijë euro në të mirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës. I kisha ftuar deputetët, kolegët e opozitës, të kenë më shumë mirëkuptim për të gjithë ne. I kisha lutur edhe një herë për arsye se vërtet janë duke na dëmtuar si imazh i shtetit. Tek e fundit, edhe veten.

Të nderuar deputetë,
Ju njoftoj se shqyrtimi i pikës së katërt të rendit të ditës do të bëhet nëse Kuvendi e miraton propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për shmangie nga Rregullorja.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, zotin Naser Osmani, që ta paraqesë propozimin për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit. Urdhëro, i nderuar zoti Osmani.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!
Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për prokurimin publik ka për qëllim rregullimin e procedurave dhe përcaktimin e kriterëve për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Organit Shqyrtues.

Duke ditur që miratimi i këtij ligji, respektivisht rregullimi i procedurave dhe kriterëve për emërimin dhe kompletimin e organeve të Organit Shqyrtues të prokurimit është i lidhur me plotësimin e kriterit për liberalizimin e vizave, Komisioni i rekomandon Kuvendit shmangien e Rregullores për shqyrtim në leximin e parë të projektligjit në seancën e sotme plenare, si dhe për shqyrtimin e dytë të Projektligjit në një seancë të re plenare, që do të duhej të mbahej po ashtu ditën e sotme.

Pas përfundimit, Komisioni do t'i shqyrtojë në parim amendamentet e nevojshme. Faleminderit!

(Opozita hedh gaz lotsjellës në sallën e mbledhjeve plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.)

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin e propozimit për shmangie nga Rregullorja në përputhje me nenin 84 të Rregullores së Kuvendit lidhur me afatet kohore për shqyrtimin e projektligjit të lartpërmendur.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. A keni mundësi të votoni, deputetë të nderuar? Votojmë tash, me ngritje dore. Administrata, ju lutem! Administrata!

Administrata, ju lutem! Qetësohuni!

Atëherë edhe një pauzë prej pesë minutash dhe vazhdojmë. Pushoni pak!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Do të vazhdojmë me seancën plenare, 69 deputetë janë në sallë.
Para se të vazhdoj me kërkesën për të votuar shmangien nga Rregullorja, kisha dëshiruar ta bëj të qartë edhe për publikun në raport me deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Sjelljet joadekuate të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk janë vetëm nga opozita. Zyrtarët policorë kanë shprehur ankesa edhe zyrtare për arsye se disa nga deputetët e pozitës i kanë fyer policët, i kanë fyer shumë rëndë. Realisht mirë është të dihet kjo edhe publikisht, për arsye se ata po ballafaqohen me fyerje nga të dyja palët edhe në të njëjtën kohë ata vetëm janë duke e kryer punën e vet për çka janë të thirrur edhe nga ligji. Do të ishte mirë të mendoni para se t'i fyeri, se nuk e keni asnjë të drejtë më shumë se ata, as familjet tuaja s'janë më të veçanta.

Urdhëro, Armend e ke fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Kryetar, diqysh jemi ngopur me gjeneralizma, nëse ka diçka konkrete, është mirë të përmendet emri i deputetit, pasi Rregullorja dhe thirrja është në mënyrë individuale, e jo kolektive. Nëse thyhen rregullat janë për individë, e jo në mënyrë kolektive për të gjithë deputetët e Kuvendit.

KRYETARI: Faleminderit, Armend!
Unë pra do ta bëj publike në seancën e radhës, kur të vijë zyrtarisht raporti i Policisë. Do t'i bëj publikisht edhe fyerjet nga kolegët e opozitës, në të njëjtën kohë edhe të pozitës. Atëherë e bëjmë kështu.

(Reagime nga salla)

Në të njëjtën kohë, po flas për sot. Atëherë, është çështja e 60 milionë e 800 mijë euro të cilat janë në pritje, e sot me këtë përbërje në Kuvendin e Republikës së Kosovës nuk do të mund të kalojnë. Ta kemi parasysh, se duhen 2/3.

Unë do të vazhdoj, pasi kryetari i Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, zoti Naser Osmani, e ka paraqitur propozimin për shmangie nga Rregullorja. Ne ishim në momentin kur kërkohej deklarimi me votim për miratimin e propozimit për shmangie nga Rregullorja në përputhje me nenin 84 të Rregullores së Kuvendit lidhur me afatet kohore për shqyrtimin e projektligjit të lartpërmendur.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim për shmangie nga Rregullorja. Votojmë tash!

Konstatoj se me 63 vota kanë për, një abstenim, Kuvendi e miratoi propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për shmangien nga Rregullorja në përputhje me nenin 84 të Rregullores së Kuvendit lidhur me afatet kohore për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik të Republikës së Kosovës.

Ndërkohë ka disa deputetë, para se të futem drejtpërdrejt në shqyrtimin e parë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, unë ia kisha dhënë fjalën deputetit Ilir Deda. Në të njëjtën kohë e ka kërkuar fjalën edhe ministri i Arsimit. Urdhëro, deputet!

ILIR DEDA: A mundemi ne sot që për një minutë të zhvishemi prej përkatësisë partiake.

(Reagime nga salla)

Nuk e respektoj rendin e ditës, unë kam hyrë këtu të ju adresohem juve, kolegë të nderuar. Ani, mos dëgjoni, nëse nuk doni të dëgjoni. Unë timen do ta kryej se kam të drejtë aq sa edhe ju. 10 minuta i kam në dispozicion të flas çka të dua unë.

(Reagime nga salla)

KRYETARI: Ilir, të kisha lutur, vazhdoje fjalimin tënd.

ILIR DEDA: Ne sot kemi hyrë në fazën më të rrezikshme të rrugëtimit të shtetit tonë. Me gjysmën e Kosovës jashtë institucioneve, gjysmën brenda. A mund të mos mendoni si shërbyes partiakë, por si qytetarë të këtij vendi? A kemi çdonjëri prej nesh obligim për këtë vend? A e dini ku do të na çojë kjo rrugë? A jeni të vetëdijshëm ku po shkojmë me këtë lloj qasje? Edhe ju duhet të ju them.

(Reagime nga salla)

Zonja dhe zotërinj,

Kosova do të përfundojë keq. Askush s'do të vijë të na e rregullojë këtë situatë. Ne do të na lënë të sharrojmë, ta shkatërrojmë vendin tonë, derisa të rimë kështu të barrikaduar me inate kundër njëri-tjetrit. A e vlen të na dalë çarja politike në rrugët e Kosovës? E nëse na ndodh ndonjë viktimitë, çfarë kemi për të menduar atëherë? Të gjithë do të turpërohemi, 120 veta që jemi zgjedhur prej qytetarëve të Kosovës. Përgjegjësi kenë edhe ju. Më së shumti përgjegjësia u takon juve se jeni shumicë. Nuk e kenë ofruar asnjë vullnet për ta tejkaluar këtë situatë duke mos i këqyrë interesat partiake. Nuk mund të thoni ne jemi shumicë dhe bëjmë çka të duam me këtë vend.

Edhe ti zëvendëskryeministër, s'mund të zgjidhesh me inat në këso situatë politike, sepse je duke e përçarë popullin. Je duke e përçarë popullin me deklaratat tua.

(Reagime nga salla)

Dilni të gjithë, dilni sepse nuk po e ndieni peshën e përgjegjësisë të cilën e kenë. Çdonjëri prej nesh e kemi peshën e njëjtë të përgjegjësisë ndaj qytetarëve tanë për këtë që po na ndodh neve. Më së lehti është të barrikadohemi e të themi 'unë jam me këtë parti dhe s'më intereson askush tjetër'. E kultura e moskomunikimit politik është kulturë primitive dhe nuk është kulturë politike.

Nëse vazhdojmë në rrugë, Teuta, do t'i biem pishman të gjithë pse s'i kemi ndërmarrë të gjitha veprimet që kemi mundur t'i parandalojmë ato çfarë mund të na ndodhë. Kemi përgjegjësi 120 deputetë individualisht. Jemi të zgjedhur individualisht dhe kemi përgjegjësi.

Dhe në fund e po ju lë, vazhdoni ju qysh të doni - pjesëtarëve të bashkësive etnike: Në përplasjen brenda shqiptare nuk është mirë të merrni anë. Është në interesin e të gjithëve që bashkësitë etnike t'i kenë raportet e mira me çdo forcë politike shqiptare. Ajo që duhet prej jush është maturia, pjekuria politike. Mos hyni në konfliktin brendashqiptar! Mos merrni anë! Duhet të na lini neve që vetë ta zgjidhim këtë problem, e mandej së bashku me ju ta ndërtojmë një Kosovë tjetër.

Edhe një herë po ju thërras - thoni çka doni: Çdo njëri prej jush duhet ta ndieni përgjegjësinë personale të cilën e keni ndaj situatës në të cilën jemi. Veç të mos jetë vonë nesër.

(Reagime nga salla)

KRYETARI: Faleminderit, Ilir! Kolegë të nderuar, ne po mundohemi për krejt atë çfarë po e bëjmë duke i shkelur të gjitha mënyrat, edhe Rregulloren, për t'u dhënë mundësi për të komunikuar brenda Kuvendit, për të dialoguar. I dhamë mundësi edhe Visarit, i morëm tri herë, tri radhë diku me dhjetëra gazra lotsjellës, janë institucionet - zgjedhja. Kisha kërkuar në qoftë se kemi mirëkuptimin ta vazhdojmë seancën. Thjesht, megjithatë, askujt nga kjo pozitë nuk i është ndaluar fjala. Shpeshherë edhe e kanë keqpërdorur mikrofonin.

Në qoftë se e dëshironi fjalën jua japi, por të mos të dalim jashtë teme. Ismet Beqiri e ka fjalën, pastaj ministri i Arsimit për çështje të cilat kanë të bëjnë me rendin e ditës.

ISMET BEQIRI: Kryetar!

Unë do të doja të them në emër të grupit, atë që e tha zoti Deda - krejt qysh e ka thënë është, veç është dashur ta thotë për subjektin që i takon dhe partive që janë bashkë në këtë bashkim, në këtë koalicion, apo si ta quajmë - opozitë e bashkuar. Të tjerat asnjëherë s'i kemi neglizhuar. Përgjegjësia dhe qëndrimi ynë është shumë i qartë, jemi për dialog, jemi për t'i shpalosur të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ato që na mendojnë të gjithë ne, por vendi është këtu - në Kuvend - por pa gaz lotsjellës.

Prandaj, unë po them në emër të grupit parlamentar, zoti Deda e ka huq këtë adresim, dhe e ka huq keq, sepse erdh e na i lëshoi një "grusht miza" - fjalë edhe pastaj shkoi. Ky është një moralizim, nuk është në rregull. Ne jemi dakord dhe prej këtu po e them - unë e di që edhe Partia Demokratike, por unë po flas edhe në emër të LDK-së, si kryetar grupi, që gjithmonë ka qenë, është dhe do të jetë gatishmëria jonë që t'i bashkëbisedojmë të gjitha çështjet këtu, por në Kuvend, e jo me gaz lotsjellës. Dëgjojini deklaratimet e tyre - po na pengojnë ta shprehim atë që na e ka thënë sovranit. I dëgjoja në mjetet e informimit. E ne kush na ka zgjedhur? Edhe ne na ka zgjedhur dikush.

Prandaj, pa dashur ta zgjas, unë ju kërkoj ndjesë, sepse nuk e kisha ndërmend të dal, por qe sa herë po na moralizojnë një apo dy individë, e pastaj po dalin. Ne të gjallë jemi. Jemi gjallë dhe dëshirojmë ta kryejmë punën tonë. Le të na lejojnë ta kryejmë punën tonë. Ne asgjë s'po i

kërkojmë më tepër si deputetë të Kosovës të këtij Kuvendi, veç ta kryejmë punën tonë, por nuk kryhet puna me ultimatume, me qëndrime të njëanshme dhe me veprime çfarë u bënë edhe sot. Kaq! Unë po e them - ne e kemi gatishmërinë, por zoti Deda, me gjithë respektin, le të flasë me partinë që i takon dhe me të tjerët që i përkrahin këto veprime që po i bëjnë këta. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Enver Hoxhaj e ka kërkuar fjalën.

ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryetar,

Zoti kryeministër, zëvendëskryeministër, Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë, zonja dhe zotërinj, qytetarë të Kosovës,

Pa dyshim që situatën në të cilën është vendi është një situatë komplekse, është një situatë e cila për disa muaj e ka dëmtuar imazhin e shtetit të Kosovës, por kur unë i shoh kolegët tanë deputetë, të cilët pas tri rundeve të gazit lotsjellës, e unë isha goxha afër atij gazi lotsjellës, mandej dalin në skenë dhe shesin moral, qoftë në emrin individual dhe të partive të tyre politike.

Unë e pranoj thënë të drejtën edhe një moral të tillë, nëse vijnë në Kuvend të Kosovës, ku është vendi që ne i ballafaqojmë idetë dhe ku nuk duhet të ballafaqohemi me gazin lotsjellës, apo me forma të tjera të dhunshme.

Kështu që, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës, edhe një herë dua që ta ftoj opozitën që të jetë opozitë demokratike, që dialogun ta kemi këtu në Kuvendin e Kosovës, ku na kanë zgjedhur qytetarët e Kosovës, që t'u përgjigjen ftesave të cilat deri më tash kanë qenë edhe nga zonja Presidente, edhe nga zoti Kryeministër. Do të thotë, dialogu duhet të jetë ose ndër-institucional, ose ndërpartiak, mirëpo ne e kemi edhe një përgjegjësi - që ky shtet në tetëvjetorin e pavarësisë së tij ta vazhdojë rrugën e tij të shtetndërtimit dhe çdo kush që beson në demokraci, që beson në një Kosovë shumetnike nuk do të duhet të paktën që t'u japë leksion se qysh dhe në çfarë forme të sillen deputetët e pakicave tjera etnike. Për mendimin tim është pakëz e tepërt që ne si deputetë të shumicës mandej të japim leksion se si të sillen pakicat dhe të tjerët. Çdo deputet në emër të tij ka mundësi dhe në emër të grupit parlamentar këtë ta deklarojë.

Kështu që në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, ne kërkojmë që të ketë dialog institucional në Kuvendin e Kosovës, dialog ndërpartiak, i kërkuar nga Presidentja dhe Kryeministri dhe vitin 2016 vërtetë ta kemi vit të një normaliteti. Faleminderit!

KRYETARI: Alma dhe Qerim Bajrami e kanë kërkuar fjalën. Cili po flet i pari. Alma, fjala për ju!

ALMA LAMA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Mendoj që duhet të na thërrisni pak më formalisht, unë jam zonja Lama, e jo Alma, se nuk njihemi personalisht.

KRYETARI: Kërkoj shumë falje, ke të drejtë.

ALMA LAMA: Jo, e kam vënë re që këtë zakonisht e përdor me deputetet, por kur është fjala për kryeministrin ose zëvendëskryeministrin, i thua “zoti Thaçi”, “zoti Mustafa”, kështu që është një lloj trajtimi i ndryshëm.

Sa i përket arsyes se pse e mora fjalën, gjatë gjithë kësaj kohe kur Kuvendi i Kosovës është shndërruar në arenë të dhunës dhe të gazit lotsjellës, nuk e kemi pasur mundësinë të flasim rreth kësaj çështjeje.

Kemi folur nëpër Facebook dhe medie, i kemi dhënë qëndrimet tona, por realisht ju si kryetar dhe si Kryesi nuk jeni kujtuar që ta thërrisni një seancë në të cilën të flitet pikërisht për këtë çështje dhe ndoshta të dilet me një rezolutë, kur Kuvendi i Kosovës në mënyrë decizive ta dënojë dhunën si mjet politik. Nuk ka nevojë të na e thonë këtë për çdo ditë vetëm ambasadat, ambasadorët, senatorët që vijnë nga vendet tjera, por ne duhet ta themi vetë në radhë të parë, e këtë mund ta bëjmë vetëm nëse ne jemi të bindur se dhuna është e papranueshme si mjet politik.

Dua gjithashtu ta denoncoj personalisht degjenerimin e diskursit publik, si brenda Kuvendit, ashtu edhe jashtë Kuvendit, nga përfaqësuesit politikë.

Sot një deputet i këtij Kuvendi i quajti kolegët e vet “minj”. Merreni me mend se ku ka përfunduar diskursi politik i Kuvendit të Kosovës! Mendoj që ne si deputetë duhet ta dënojmë çfarëdo lloj gjuhe të papranueshme, sepse siç e keni parë kjo çfarë po ndodh në Kuvendin e Kosovës po reflektohet në mënyrë jashtëzakonisht negative edhe në Kosovë, edhe nëpër institucione. Për shembull, para pak ditësh pashë skenë jashtëzakonisht trishtuese në një shkollë, ku nxënësit nuk e pranonin mësuesin. Merreni me mend, digjnin goma kundër mësuesit. Pra, kjo po përsëritet nëpër institucione të ndryshme në gjithë shoqërinë, sepse Kuvendi është modeli, në fakt është shtëpia e demokracisë që duhet të reflektojë edhe kulturë politike, e kjo nuk po ndodh në Kosovë.

Unë propozoj që të mbahet një seancë së shpejti, në të cilën të flitet për këto probleme madhore që e kanë përfshirë Kuvendin e Kosovës. Kuvendi është vendi ku kuvendohet, kështu që mendoj që kjo duhet të bëhet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Lama!

Deputeti Qerim Bajrami e ka fjalën, e pastaj vazhdojmë me shqyrtimin e projektligjit në shqyrtim të parë.

ĆERIM BAJRAMI: Poštovani poslanici Parlamenta Republike Kosova,

Poštovani premijeru,

Zamenici premijera,

Poštovani predsjedniće Parlamenta,

Ja sam Bošnjački poslanik ovde ispred Bošnjačke zajednice, a ovo ću reći u svojoj lično ime.

Po drugi put da čujem u ovoj Skupštini da neko meni kaže da nisam poslanik Kosova. Želim da se javno izjasnim da zadržim izjavu za sebe.

Onog momenta kada ja ne budem poslanik ispred celog Kosova, neću ni biti u ovoj Skupštini. Neka svako govori u svom imenu. Oko ovoga smo da smo načisto.

Drugo, ako meni neko grani da imamo svoj lični stav o onome što se ovde događa, koga ću ja podržati ili koga neću podržati neka takođe zadrži za sebe svaki taj savjet, jer te savjete nisam prihvatio ni u vreme kada je u ovoj državi bilo veoma teško celom ovom narodu na Kosovu, i od onih koji su bili mnogo jači, imali su mnogo veću silu. I tada sam rekao ne, i ne očekujem pogotovo od gospodina Ilira Dedu, jedno poznato demokrate, da nas savetuje po ovom pitanju.

I treće, govorim dakle u svoje ime, ali verujem da će se složiti i predstavnici drugih nevećinskih zajednica, mimo srpski.

Mi smo zajednice koje su institucionalne. Mi sledimo Ustav i zakone Kosova. Onoga momenta kada gospodin Ilir Deda bude premijer Kosova, verovatno mi ćemo opet biti pozicija, jer to nas obavezuje Ustav Kosova, i nas niko ne može da isključi kao većinske predstavnike naših zajednica da ne budemo deo institucionalnog sistema na Kosovu.

Ako u ovom momentu koalicija PDK i LDK ona koalicija koje ima većinu ovdje u Parlamentu, sasvim je prirodno, normalno, ustavno i zakonski da mi budemo deo te koalicije. U protivnom, mi nemamo pravo da budemo u ovom Parlamentu, jer na primer nas dvoje Bošnjački poslanika smo trenutno većinski predstavnici bošnjaka ovde u Parlamentu.

Mi možemo podneti ostavku, ali će na naše mesto doći neko koji će biti deo ove vlasti. To je ustavni zakonski sistem Kosova, to takođe važi i za predstavnike većinske srpske zajednice, i za predstavnike drugih zajednica. Ako neko ovo ne zna, neka ponovo pogleda Ustav i zakone Kosova, i nemoj danas niko savjetuje šta treba mi da radimo.

Oko razrešenja krize, ako ista znači moja reč, ja pozivam naše poštovane poslanike iz opozicije da prestanu da nas ovde siluju svih ovih meseci, jer mi nismo zaslužili da nas niko gađa ni suzavcem, ni bilo čime, niti su oni zaslužili. Neka dođu ovde sa nama, neka budu ovde da demokratski i u okviru Ustava i zakona Kosova razrešimo probleme.

Ja sam spreman da pružim svoj minimalni skromni doprinos, jer imam takođe dobro odnose i sa predstavnicima opozicije. Izvolite formirajmo ovde jednu grupu unutar Parlamenta, pa da pokušamo da razrešimo ovaj problem. Ali ovako svakako ne ide, a to što će neko odlučivati ako je manjina ovde na Kosovu da mi sutra idemo na izbore, neka izvinu, o tome ćemo se i mi pitati, i dokle god se pita većina izvora skoro neće biti, jer postoji i drugo rešenje, i mi trebamo da ga nađemo ovde, u okviru ovoga Parlamenta, i u okviru ovih institucija.

I završiću na kraju, a nije nevažno. Jedan hrvatski predstavnik mi je rekao na jednoj regionalnoj konferenciji: Mi znamo temperament Albanaca, i kada krenete negde ne znate da se ustaviti. Neka o ovome razmisli. Ako ova djela ne prekinu, kaže vaša opozicija na Kosovu, Kosova će mnogo izgubiti na regionalnoj i međunarodnoj sceni. Niko nas neće čekati da se već dogovaramo kako koji problem nastane, da mi idemo ponovo na nekakve izbore.

Druge regije i druge države u regije idu naprijed, i neće nas čekati sigurno da razrešimo naše unutrašnje probleme. Izvolite da nastavimo institucionalni život, ovde smo da pružimo punu podršku. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! I nderuar ministër, urdhëro! Ka të bëjë me rendin e ditës.

MINISTRI ARSIM BARJAMI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuari kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Duke qenë që Projektligji për arsimin e lartë është një reformë shumë e rëndësishme për arsimin e larë, duke pasur parasysh se sot kemi disa marrëveshje ndërkombëtare dhe disa ligje me rëndësi për liberalizimin e vizave dhe me shpresë që në debatin për këtë ligj do të kthehen në Parlament dhe do të marrin pjesë edhe kolegët nga opozita, kërkoj që ky projektligj të shtyhet për një seancë tjetër, kur do ta kemi pjesëmarrjen edhe të kolegëve opozitarë që t'i japin shumë rëndësi debatit për këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Kur të vijmë te pika e rendit të ditës. Profesor, pate diçka? Jemi në pikën e katërt tash.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik të Republikës së Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Abdullah Hoti, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër,

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj i rregullon procedurat dhe kriteret e emërimit të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, arsyet e shkarkimit, si dhe organizimin e brendshëm të OSHP-së.

Pra, çështjet që ka të bëjë me dispozitat e këtij projektligji lidhen vetëm me organin shqyrtues të prokurimit publike, me bordin dhe organizimin e tij.

Është një projektligj i shkurtër, me tri nene.

Neni i parë e përcakton numrin e anëtarëve të Bordit të OSHP-së prej pesë anëtarëve, me mandat pesëvjeçar, pa të drejtë rizgjedhje.

Neni i dytë e përcakton mënyrën e largimit dhe suspendimit të anëtarëve të OSHP-së.

Dhe, neni i tretë, e rregullon organizimin e brendshëm të OSHP-së edhe në situatën kur kryetari i OSHP-së për arsye të ndryshme nuk mund ta kryejë punën e tij në mënyrë normale.

Ky projektligj lidhet gusht me Programin qeverisës 2015-2018 dhe me kriteret për liberalizimin e vizave, prandaj kërkoj nga ju që ta miratoni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Të nderuar deputetë, pas prezantimit të projektligjit hap debatin për diskutim në parim.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, zoti Naser Osmani, që ta japë qëndrimin.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Në bazë të nenit 56, paragrafi 2, të Rregullores së Kuvendit për shqyrtim në parim të projektligjit, Komisioni për buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar dhe e ka diskutuar. Prandaj, ia kemi dhënë edhe rekomandimin Kuvendit që të përkrahet në parim ky ndryshim i Ligjit për prokurimin publik.

Kuvendit i kemi rekomanduar që sot të mbahen dy seanca, meqenëse kjo është një çështje e kushtëzuar lidhur me çështjen e liberalizimit të vizave.

E kemi diskutuar dhe edhe me Zyrën e BE-së dhe jemi dakorduar për ndryshimet që duhet të bëjmë edhe në emërimin e OSHP-së dhe pavarësinë e këtij institucioni, po ashtu jemi dakorduar edhe për mënyrën e suspendimit, respektivisht largimit apo shkarkimit të anëtarit të OSHP-së dhe konsideroj që në një moment, kur ju e shihni të arsyeshme, zoti kryetar, të na jepni një pushim Komisionit për Buxhet dhe Financa që bashkë me ministrin e Financave ta bëjmë ndryshimin dhe t'i sjellim amendamentet për votim, meqenëse kemi punuar dhe i kemi të gatshme. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Osmani!

Tani është radha e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Safete Hadërgjonaj, nga Partia Demokratike e Kosovës.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Para se të flas për projektligjin, kisha kërkuar që të gjithë ata që po na e zënë frymën me gaz lotsjellës, të japin përgjegjësinë individuale për veprimet të cilat i bëjnë.

Unë e kam përgjegjësinë, edhe të votuesve të mi, edhe të votuesve të partisë sime politike, me të cilën kam ardhur në Kuvendin e Kosovës, për të punuar për të mirën e vendit tonë.

Prandaj, kërkoj që të veprohet vërtet në mënyrë institucionale, që të na krijohet mundësia për të punuar dhe të mos na zihet fryma siç ka ndodhur sot. Neve po na rrezikohen shëndeti dhe jeta jonë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i

plotësuar me Ligjin 04/L-237 dhe Ligjin 05/L-068 e përkrah këtë projektligj dhe ne jemi të angazhuar që të punojmë në Komisionin për Buxhet dhe Financa, duke formuar qoftë edhe grup të posaçëm për të punuar që të mos na rrëshqasë ndonjë veprim apo ndonjë e metë brenda këtij ligji, në mënyrë që të mos marrim vërejtje nga Bashkimi Evropian për mosplotësimin e kriterëve të cilat kërkohen nga Bashkimi Evropian dhe në mënyrë që ligji të jetë në plotësi apo në harmoni me kërkesat nga Bashkimi Evropian.

Është ligj që duhet të miratohet në mënyrë që të plotësohen kriteret të cilat kërkohen për liberalizimin e vizave dhe unë nuk e kuptoj pengesën që na u bë sot që pikërisht ky ligj, që ka të bëjë me liberalizimin e vizave dhe është kërkesë e domosdoshme, të miratohet sa më shpejt. Ne pikërisht sot e kemi pengesën më të madhe nga një grup i caktuar i njerëzve, të cilët faktikisht nuk e njohin shtetin e Kosovës dhe janë të interesuar që ta rrënojnë çdo gjë që ka të bëjë me ndërtimin dhe funksionimin e shtetit të Kosovës, gjë që është shqetësuese për një grup tjetër të njerëzve, të cilët i janë bashkëngjitur këtij grupi që po i fundos themelet e shtetit tonë, e që e ka njohur shtetin e Kosovës dhe faktikisht u janë bashkangjitur.

Prandaj, ne si grup parlamentar kishim kërkuar që krahas ndryshimeve, të cilat janë bërë në projektligjin, i cili na ka ardhur nga Qeveria, të bëhet edhe një ndryshim tjetër që ka të bëjë me nenin 21 të ekonomizimi i aktiviteteve të prokurimit.

Në projektligj është shënuar që në ligjin i cili është plotësuar dhe ndryshuar për herë të fundit është kërkuar që me qëllim të ekonomizimit të aktiviteteve të prokurimit, Kuvendi i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ministrinë përkatëse t'i kryejnë procedurat e prokurimit të agjencive të pavarura që u përgjigjen atyre të cilat kanë më pak se 50 punonjës.

Me këtë nen është paraparë që në të gjitha institucionet e pavarura, të cilat i raportojnë Kuvendit, të bëhen procedurat e prokurimit. Faktikisht, një nen i tillë është i pazbatueshëm për arsye se Kuvendi i Kosovës nuk ka kapacitete që t'i kryejë të gjitha procedurat e këtyre institucioneve.

Prandaj, të gjitha ato institucione të cilat i kanë njësitë e prokurimit të formuara duhet t'i kryejnë vetë procedurat e prokurimit, përndryshe ne menjëherë, në mënyrë që ligji të jetë i zbatueshëm, duhet të marrim qëndrim, apo të vendosim që të shtohet numri i personave, të cilët do të punojnë në zyrën e prokurimit, sepse me kapacitetet ekzistuese nuk mund të kryhen të gjitha këto veprimtari, të cilat kërkohen sa i përket prokurimit publik.

Prandaj, ne prapë do të marrim vërejtje nga institucionet ndërkombëtare për moszbatueshmërinë e këtij neni.

Prandaj, në këtë rast kërkoj që neni 21, pika a., të jetë i formuluar kështu: "Për qëllimet e ekonomizimit të aktiviteteve të prokurimit, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ministrinë përkatëse t'i kryejnë procedurat e prokurimit të agjencive që u përgjigjen atyre të cilat kanë më pak se 50 punonjës. Me aprovimin e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, bazuar në kërkesën e arsyetuar të autoritetit kontraktues, agjencitë që kanë më pak se 50 punonjës mund t'i zhvillojnë procedurat e prokurimit. Agjencitë e pavarura që i përgjigjen Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilat nuk kanë njësi të prokurimit, procedurat e prokurimit të zhvillohen nga autoriteti qendrorë i prokurimit".

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah në parim Projektligjin dhe do ta japim kontributin tonë në plotësim-ndryshimin e tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Hadërgjonaj!
Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit!
Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin që ka të bëjë me ndryshimin e Ligjit për prokurimin publik.

Ajo çka ne kërkojmë në këtë moment të propozimit është saktësimi që të bëhet në mënyrën e emërimit, shkarkimit dhe përzgjedhjes dhe e cila është në harmoni edhe me kërkesat që kanë dalë edhe nga Raporti i Progresit, por edhe si kërkesë për çështjen e liberalizimit të vizave.

Por, si grup parlamentar kërkojmë, apo të merret edhe si rekomandim për Qeverinë e Republikës së Kosovës, që të hartohet ligji i ri komplet dhe të inkorporohen të gjitha dilemat, edhe këto çka i tha kolegja deputete, sepse ndërhyrje tash në këtë fazë, sipas Rregullores së Punës së Kuvendit dhe meqë kemi të bëjmë me hartimin e legjislacionit, nuk është e mundshme.

Andaj, propozojmë që të gjitha propozimet të integrohen, sepse vetëm ky ligj ka ardhur shumë herë në plotësim-ndryshim, por asnjëherë nuk e ka një saktësim të qartë dhe problematikat po lindin në vazhdimësi.

Sido që të jetë, ne i japim përkrahje kështu siç është. U japim përkrahje edhe propozimeve që do t'i paraqesin deputetët për rregullimin apo saktësimin e këtyre tri amendamenteve dhe besojmë që shumë shpejt do të vijë ligji i ri, e të gjitha këto do të jenë pjesë integrale dhe nuk do të ketë më problematikë në të ardhmen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Zemaj!
Nga Grupi Parlamentar “Vetëvendosje” nuk kemi. AAK-ja nuk kemi. Lista serbe, kush e do fjalën? Urdhëro zoti Simiq.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče!
I Poslanička grupa Srpske liste razmatrala Nacrt zakona o javnim nabavkama, razmatrali smo izmeni i dopune u stopu ovog zakona, i mi u načelu podržimo ovaj Nacrt zakona i svoj doprinos ćemo dati kroz Komisiju za budžet i finansije u kreiranju ovog zakona. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Simiq! Tani nga “6+” e ka fjalën zoti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, i nderuar kryetar!
Edhe Grupi Parlamentar “6+” e përkrah në parim Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për prokurimin publik. Rekomandimet tona do t'i paraqesim në Komisionin Funkcional.

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar “Nisma” nuk është askush. Nga deputetët, zonja Teuta Sahatqija e ka fjalën.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Mendoj që Ligji për prokurimin publik të Republikës së Kosovës është ligj për të cilin në radhë të parë ka interes Kosova, e pastaj edhe të tjerët. Por, në anën tjetër, ne e dimë që ky ligj është kriteri i fundit i kërkuar nga BE-ja për liberalizimin e vizave.

Ne e patëm si Komision për Integritet Evropian në fund të muajit të kaluar një vizitë në Bruksel.

Gjatë asaj vizite ishte i pranishëm i gjithë komisioni, të gjithë deputetët e pozitës dhe të opozitës ishim së bashku dhe në takimet e shumta të cilat i kemi pasur kemi tentuar që të gjithë së bashku t'i bindim zyrtarët e Brukselit dhe shtetet të cilat do të votojnë për liberalizimin e vizave se Kosova është e denjë dhe duhet të ketë liberalizim të vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës. Bile kur e morëm propozimin prej zyrtarëve të lartë të Parlamentit, të komisionit e të tjera, që pikërisht ky komision në të cilin ishin deputetët e pozitës dhe të opozitës të bëjnë edhe vizita në shtetet ku ministrat e Punëve të Brendshme do të votojnë së shpejti për liberalizimin e vizave, aty nuk patëm as pozitë as opozitë, por të gjithë ishim së bashku për këtë.

Prandaj, mendoj që si kriter i fundit, i cili duhet sot patjetër që të votohet, ishte shumë e pakuptimtë që të pengohet puna e Kuvendit dhe të pamundësohet votimi i kriterit të fundit, i cili do t'i përmbyllë të gjitha kërkesat teknike që kërkohen prej Kosovës lidhur me liberalizimin e vizave.

Ne e dimë që së shpejti e presim një vizitë nga Brukseli dhe presim që edhe zoti Avramopulos të vijë dhe të shqyrtojë nëse janë plotësuar të gjitha kërkesat teknike nga Kosova për të bërë liberalizimin e vizave.

Prandaj, e gjithë kjo përzënie e deputetëve tri herë me radhë dhe pamundësia që ne së bashku të tregojmë që liberalizimi i vizave nuk ka pozitë dhe opozitë ishte me të vërtetë i pakuptimtë.

Zoti Ilir Deda e përmendi emrin tim. Unë mendoj që ai e pati një fjalim të mirë. Mendoj që në fjalim e tij ai e ceku kohën e vështirë nëpër të cilën po kalon Kosova, por mendoj që audienca e cila ishte e ulur këtu nuk ishte e mjaftueshme për atë, prandaj shpresoj që fjalimin e pati për një audiencë tjetër, e cila me siguri e ndjekë nëpërmjet televizorit.

Dhe, mendoj që kërkesa e tij për të biseduar dhe për reflektuar ishte një kërkesë shumë substanciale dhe e mirë. Por, vendi për të biseduar është Parlamenti i Kosovës. Ne qytetarët na kanë zgjedhur që të ulemi këtu edhe që të diskutojmë, që të flasim dhe të gjejmë zgjidhje.

Prandaj, shpresoj që reflektimi do të ndodhë nga secila anë dhe të vihet në Parlamentin e Kosovës, të diskutohet, të gjendet zgjidhje dhe ta tejkalojmë këtë situatë në të cilën fatkeqësisht gjendemi.

KRYETARI: Faleminderit, zonja Sahatqija! Tani fjalën e ka zoti Zenun Pajaziti. Nuk ka deputetë tjerë të paraqitur.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kryeministër, Kabinet qeveritar, deputetë,

Ndonëse shumica nga ne ndoshta kishim pasur nevojë tash t'i japim përgjigje deputetit që na dha leksionin dhe iku nga salla, por mendoj që duhet t'i kthehemi rendit të ditës dhe një debati normal. Shpresoj që edhe në mungesë të opozitës, ne do të mund ta zhvillojmë një debat sa më normal për çështje që janë jetike për këtë vend.

S'do mend që edhe Ligji për prokurimin publik, edhe pas asaj kërkesës tjetër për instalimin e prokurimit elektronik, edhe këtyre kërkesave që tashmë janë kritere të fundit për liberalizimin e vizave, duhet t'u kthehemi sa më seriozisht.

Duhet ta shfrytëzoj edhe praninë e Qeverisë dhe të kujtojmë që jo vetëm plotësim-ndryshimi i këtij ligji është sfidë për liberalizimin e vizave edhe për kriteret tjera që janë për procesin e stabilizim-asocimit. Bile prokurimi është pika më e zezë, që është përsëritur disa herë në Raportin e Progresit dhe në vlerësimet e atyre që monitorojnë punën tonë si institucione në Kosovë.

Pra, të mos gëzohemi nëse plotësim-ndryshimi i këtij ligji mund të thuhet se është kriteri i fundit, por duhet ta keni parasysh, sidomos ju që keni përgjegjësi direkte për zbatimin e ligjit, se edhe zbatimi i ligjeve ekzistuese nuk ka qenë në nivelin e duhur. Prandaj, edhe plotësim-ndryshimi i këtij ligji nuk është se ne automatikisht mund t'i realizojmë këto kritere. Pra, kërkoj që të ketë një vlerësim të duhur për zbatimin e këtyre ligjeve dhe të ketë kujdes sidomos në zbatimin e ligjit, sepse prokurimi publik është pjesa më e përfolur, më delikate, dhe pjesa aty ku gjithmonë kemi pasur dhe kemi vazhdimisht vërejtje nga institucionet tjera.

Pra, unë e mbështes plotësisht plotësim-ndryshimin e këtij ligji, por kërkoj që institucionet përkatëse të kenë kujdes në zbatimin e plotë të këtij ligji në të gjitha nivelet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Pajaziti!

Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh se nuk ka të lajmëruar më për diskutime, do të kërkohet tani nga ju deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit. Në sallë aktualisht e kemi praninë fizike 74 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim! Votojmë tash!

Konstatoj se me 70 për dhe dy abstenime, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik të Republikës së Kosovës.

Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në pajtim me vendimin e seancës së datës 19 shkurt 2016 ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime për shqyrtim të dytë në seancën plenare të radhës, e cila do të mbahet po ashtu sot.

Tani, për shkak të asaj, që e thashë në fillim, mungesës së 2/3-ve të deputetëve, do të kalojmë në disa pika të rendit të ditës. Ndërkohë, pa u futur në pikën e dhjetë të rendit të ditës, deputeti Sabri Hamiti ka kërkuar fjalën. Urdhëroni, Profesor!

SABRI HAMITI: Zoti kryetar!

Zoti kryeministër,

Pjesëtarë të Qeverisë,

Deputetë,

Kolegë të nderuar,

Unë do të flas për këtë seancë sot dhe dy-tri fjalë që s'mund të mos i them, sepse e kemi një sezon që s'kemi pasur shans të flasim atë që mendojmë, për shkak të tipave të mbledhjeve jo të zakonshme, që i kemi bërë.

Së pari, zoti kryetar, unë propozoj që, natyrisht nëse pranojnë kolegët deputetë, për t'u bërë racionalë në punën që na pret sot, u mor vesh që 5 pikat në vazhdim nuk votohen dhe nuk votohen për shkak se nuk i kemi 2/3-at dhe në këtë rast - pse nuk i kemi 2/3-at nuk ka faj opozita, por ka faj pozita. Këtu bile, të mos u lëmë faj këtu, se 2/3-at i ka pozita, për çdo ditë trumbeton dhe thotë se vërtet i ka ato shifra, por kur duhet funksionalisht nuk i ka. Edhe Ligji për arsimin i ka 2-3 përcaktues të tjerë pse s'mund të kalohet sot, njërin e tha ministri, por nuk është vetëm ai, ka edhe përtej kësaj. Prandaj, meqë kjo pjesë plus e kemi edhe një nen të Kushtetutës, që nuk po përmendet, edhe ajo kalon, sepse nuk i kemi 2/3-at.

Pra, krejt çka duhet 2/3-at të kalohet, kjo po dihet. Por, meqë tash kemi dy-tri blloqe të punës së Kuvendit, që janë kaq të ndryshme me njëra-tjetrën, janë 6 ligje, pastaj janë katër-pesë raporte dhe janë dy lloje zgjidhjesh, unë kisha propozuar, për t'u bërë më konkret sot, më të arsyeshëm në kërkesa dhe në punë, të vendosim që raportet të mos trajtohen sot, sepse edhe ashtu nuk janë raporte që lidhen me një datë, sepse disa janë mjaft të vonuar. Të procedohet me leximin e propozim-ligjeve dhe të shkohet në dy zgjedhje, të cilat duan mjaft kohë. Ky është propozimi im, varet prej grupeve, duan a s'duan.

E dyta, që desha ta them, janë edhe nja dy-tri fjalë për një sezon të tërë të Parlamentit të Republikës së Kosovës dhe për këtë të dytën, që nisi sot. Nuk mund të mos e them këtu para të gjithë kolegëve, perceptimet, për më tepër, mënyrën e të menduarit, bile edhe të ndjesisë që kam për këto zhvillime, që janë zhvillime politike brenda Parlamentit, por janë përtej këtij Parlamenti, janë në shoqërinë e Kosovës, e besa me raportet që i kemi si një shoqëri e hapur edhe përtej saj.

Nëse nisemi nga pamjet e sotme që i kemi prej ardhjes prej ku jetojmë deri në këtë sallë, pamje joimpresive e mirë rreth Parlamentit të Republikës së Kosovës, pamje joimpresive e mirë mënyra e hyrjes në derën e Parlamentit të Kosovës, pamje tymnajë brenda në sallën e Parlamentit të Kosovës. Kjo qëndrueshmëri e sojit të veçantë, edhe e pozitës, që jemi ne këtu, edhe e opozitës, nëpër gjithë këtë tym, është për studim. Pse? Sepse, na janë shfaqur shenjat e vërteta. Shenjat e vërteta, për të mos thënë edhe të dhënat dhe faktet, që këtu ka tendencë, po përdor gjuhë të rezymuar, por jo të figuruar, që të legalizohet dhe të legjitimohet dhuna - dhuna politike dhe njerëzore, e cila nëse duket në Parlament, ta dini që duket shumë më e ndjeshme përtej tij, sepse llogaritet që në kuptimin e kulturës politike të kundërvënies dhe të gjetjes së konsensusit, për kah natyra njerëzit këtu janë më të kulturuar politikisht.

Pra, është moment për reflektim të fortë, të rëndë, të secilit, por jo në kuptimin që t'i japim shenjë të mirë pozitive ose negative njëri-tjetrit pse është në këtë parti a në atë parti, sepse në një sistem pluripartiak konkurrohet me parti për të hyrë në këtë Parlament, kështu që as s'mund ta lavdërojmë veten pse jemi në parti e t'i shajmë të tjerët, as të tjerët t'i lavdërojmë, e veten ta shajmë. Pra, ky argument nuk pi ujë prej askujt, sepse të gjithë janë të zgjedhur me të njëjtin ligj, me një votë popullore dhe mbajnë përgjegjësinë e zgjedhjes edhe të programeve dhe ekzistojnë detyrimet e programeve, nëse s'ekzistojnë detyrimet e mandatit, qysh thotë Kushtetuta.

Prandaj, duhet të kalohet gjithmonë përtej kësaj, por jo t'i mbajmë mësimet njëri-tjetrit të panevojshme, sepse jemi të zgjedhur me të njëjtin ligj, në një njësi zgjedhore në krejt Kosovën, në një mënyrë të propozimit. Ka deputetë të pavarur, por në këtë Parlament unë nuk e di nëse ka ndonjë deputet të pavarur, që ka konkurruar i pavarur, domethënë ajo mundësi ekziston.

Prandaj, në këtë kuptim, desha të them, të mos i individualizojmë problemet. Problemi më i madh është ky, e thashë, që kam frikë dhe ka të dhëna, që në Kosovë po do të legalizohet dhuna dhe dhuna politike, që është rrezik i jashtëzakonshëm dhe s'ka të bëjë kjo më veç me këtë Parlament, s'ka të bëjë vetëm me këtë përbërje, por pasojat duhet të jetë shumë të këqija, shumë të mëdha.

Po përpiqem edhe një herë thashë të mos flas me figura, pse. Në të folurit e njëjtë edhe në këtë foltore, edhe jashtë saj, edhe në këto komunikimet e famshme që janë bërë rrjetet sociale, siç po u thonë, njerëzit janë vetëdijshëm se janë ata që janë dhe po përdorin figura, të cilat janë të diskursit të idiomës popullore shqipe.

Kur i thonë njëri-tjetritin kush nuk hidhërohet, kur e marrin komunikimin publik figurat kthehen në gjuhën e zakonshme, edhe dalin tragjike. Pra, kujdesi i diskursit politik disiplinon edhe raportet, ky është perceptimi im po them në mënyrën më të butë - kjo është bindja ime e tashme.

Kështu, do të thosha që është mirë që në këtë sallë dhe përtej kësaj salle në diskutimet politike pozitive-opozitive, në diskutimet individuale kur flasin për një problematikë mundësisht të flitet me gjuhën e saj, sepse po ndodhin moskuptime totale, të cilat po shkojnë deri në nivelin sa t'u japim të drejtë të tjerëve. Nuk është hera e parë, unë jam këtu disa legjislatura, në secilën dikujt i ka dalë rend prej anash ta përshkruajë karakterin e shqiptarit, që është, do të thosha, gati e palejueshme, pretendim mos pyet, sepse ai është një perceptim, e ne nëse duam të mos na i përshkruajnë karakteret individuale dhe kolektive, sepse ato nuk janë esenca në një rrethanë, sepse ekziston ajo që është e përhershme rrethanore.

Një njeri kur është i revoltuar, edhe më i mençuri nuk sillet sikur është i qetë, kështu që të mos bëjmë karakteristika, atëherë le të bëhemi ne të zotët të flasim me gjuhën që e marrim, qoftë të figuruar ose të pafiguruar ndërmjet vete dhe t'i bëjmë përfundimisht referencat e brendshme. Referencat i bie shembujt, ku mbështetemi, pikat mbështetëse. Pikat e forta mbështetëse në politike, në kulturë, në marrëdhënie të jashtme, në marrëdhënie me njëri-tjetritin duhet të bëhen të brendshme për të qenë në situatë të merremi vesh më lehtë dhe për të qenë në situatë për të marrë vendime më lehtë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Hamiti! Atëherë, e kemi një propozim konkret që realisht këto pikat, të cilat i përmenda me 2/3 largohen vetvetiu për shkak të mungesës së kuorumit. Por, në të njëjtën kohë është edhe propozimi i ministrit të Arsimit për largimin nga pika e rendit të ditës për sot - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

Pastaj, propozimi i zotit Hamitit që të hiqen pikat 17, 18 dhe 19. E kisha kërkuar qëndrimin nga grupet parlamentare, kryetarët e grupeve parlamentare, përfaqësuesit e grupeve parlamentare rreth këtij propozimi.

Elmi Reçica nga PDK-ja, Ismet Beqiri nga LDK-ja, pastaj grupet tjera.

ELMI REÇICA: Faleminderit, zoti kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Grupi parlamentar, për shkak të racionalizimit, normalisht e mbështet këtë propozim dhe duhet pasur parasysh që vërtet të gjithë deputetët tashmë janë të etur për t'i prezantuar qëndrimet dhe veprimet e tyre, por dua vetëm të rikthehem te çështja e mëhershme.

Është shumë mirë që opozita të deklarohet këtu, të bisedojë këtu, të prezantojë qëndrimet e saj këtu në formën çfarë e prezantoi deputeti Dedaj, pavarësisht na pëlqeu, apo s'na pëlqeu. Por, është shumë më mirë se sa të futet gaz lotsjellës dhe të bëhen veprime të tilla. Unë mendoj që deputeti Dedaj, si njeriu që ka ardhur nga shoqëria civile dhe njëkohësisht i cili është edhe në Komisionin për Integritet, së paku ka qenë dashur të mbetet këtu për pikën e katërt të rendit të ditës, meqë ka qenë shumë aktiv dhe ka punuar për këtë çështje.

Grupi ynë parlamentar e mbështet këtë qëndrim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Reçica! Zoti Ismet Beqiri, shef i Grupit Parlamentar të LDK-së.

ISMET BEQIRI: Faleminderit! Edhe ne e mbështetim propozimin që sot këto pikat që kanë të bëjnë me raportet e ndryshme që të mos shqyrtohen dhe të shkojmë në lexim të projektligjeve, ashtu siç janë të parapara.

KRYETARI: Faleminderit! Lista serbe, ok! "6+", ok! Ok, e pranon. E bëjmë një votim formal për çdo rast vetëm me ngritje dore për këtë çështje? Faleminderit! As s'i kam mbyllur, as nuk po di si t'i hap. Ata që i kanë mbyllur, le t'i hapin dyert. Le t'i hapin dyert, se deputeti, përkatësisht anëtari i Kryesisë tash 15 minuta po pret zoti Petroviq.

Atëherë, kalojmë në pikat e radhës, të cilat kanë mbetur për shqyrtim.

Urdhëro Profesor, aktivizoje më mirë që të na dëgjojnë kolegët dhe publiku.

SABRI HAMITI: Zoti kryetar, për t'u bërë shumë më efikas, ne kemi vendosur tash që të bëhet leximi i dytë i ligjit të parë që e kaluam. Unë kisha thënë që komisionet që duhet ta shqyrtojnë të tërhiqen, sepse kemi një forum të punojmë për tjerat, ta kryejnë punën në mënyrë që në

momentin kur ata e bëjnë këtë, ta votojmë. E shpallim atë mbledhje dhe e votojmë. Është më rationale. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vetëm një moment, a ka mundësi numrin e deputetëve, sa e kemi? Në qoftë se kemi kuorum, është mirë që komisioni të tërhiqet. 10 janë, por 11, flas edhe për opozitën kur flas për 11, janë 4 minimum. 7 veta të largohen, 73 janë, kemi kuorum të mjaftueshëm.

Le të largohet komisioni, vazhdojmë me pikën ku mbetëm:

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuessve dhe punëdhënësve

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjit dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, zotin Arban Abrashi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ARBAN ABRASHI: I nderuar kryetar i Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Deputetë,

Në pika të shkurtra më lejon ta prezantoj Projektligjin për ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuessve dhe punëdhënësve. Ky projektligj për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuessve dhe punëdhënësve është ligj bazik për rregullimin e veprimtarisë së shërbimit të punësimit. Me këtë projektligj do të rregullohet materia e cila paraprakisht ka qenë e rregulluar me Ligjin për regjistrimin dhe evidencën e të papunëve dhe punëkërkuessve.

Projektligji për ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e punëkërkuessve, të papunëve dhe punëdhënësve përcakton shërbimet, të cilat do të ofrohen nga zyrat e punësimit për klientët, punëkërkuessit, të papunët dhe punëdhënësit. Po ashtu, me këtë projektligj përcaktohen edhe masat aktive të tregut të punës, të cilat do të zbatohen nga shërbimi i punësimit, si: subvencionimi i pagave, punët publike, vetëpunësimin, ndërmarrësia, trajnimi në punë, praktika në punë etj. Në kuptimin përmbajtësor ky ligj ka për qëllim kryesor uljen e shkallës së papunësisë nëpërmjet harmonizimit të shërbimeve, të cilat ofrohen nga shërbimi i punësimit me sistemin e të dhënave të tregut të punës.

Pra, ligji harmonizohet me këtë sistem, krijon bazën ligjore për ofrimin e shërbimeve publike të punësimit nëpërmjet burimeve shumëkanalëshe. Nëpërmjet këtij ligji synojmë ta rritim interesimin e punëdhënësve për t'i frekuentuar zyrat e punësimit, sepse vetëm në këtë mënyrë mund t'i rritim mundësitë e identifikimit të vendeve të reja të punës duke krijuar kështu më shumë mundësi për punëkërkuessit, punëdhënësit, të papunët e regjistruar pranë zyrave të punësimit.

Projektligji është hartuar në bashkëpunim të plotë me partnerët ndërkombëtarë, si UNDP, Banka Botërore, “ILO”.

Duke marrë parasysh rëndësinë në fushën e punësimit dhe zvogëlimit të papunësisë, ju ftoj që ta aprovon këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Pas këtij prezantimi të projektligjit e hap debatin për diskutim në parim. Fjalën e ka kryetarja e Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, zonja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit ministrit për prezantimin e Projektligjit në shqyrtim të parë për ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve.

Sigurisht që ky është një ligj shumë i rëndësishëm për këtë kategori dhe komisioni do t’i qaset me shumë seriozitet dhe unanimisht që projektligji sa më parë të vijë i kompletuar me amendamentet përkatëse. Gjithashtu, shpreh mendimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, e cila aprovon shqyrtimin e parë të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Brovina! Tani fjalën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Për PDK-në e kemi qëndrimin, për Lidhjen Demokratike të Kosovës zoti Hatim Baxhaku e ka fjalën.

HATIM BAXHAKU: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Ligji që ka qenë në fuqi deri më sot dhe që e ka rregulluar këtë fushë ka arritur të sigurojë një bazë solide për rregullimin e procedurave të regjistrimit dhe evidentimit të papunëve dhe punëkërkuesve.

Në procesin e zbatimit janë evidentuar disa sfida dhe mangësi, të cilat e bëjnë të domosdoshëm procesin e ndryshimit dhe plotësimit të tij. Projektligjin që e kemi sot këtu para nesh siguron që të jetë më i saktë në rregullimin e çështjes së mbajtjes së evidencës së të punësuarve dhe punëkërkuesve, regjistrimin dhe evidencat për të punësuarit dhe punëkërkuesit, kartelën e papunësisë, lajmërimin në zyrat e punësimit, obligimet e zyrave të punëkërkuesve, obligimet e të punësuarve dhe punëkërkuesve, ndërprerja e mbajtjes së evidencës së të punësuarve dhe punëkërkuesve, fshirja nga evidenca e të punësuarve dhe punëkërkuesve, rievidentimi, e drejta e qasjes në të dhënat personale, evidencat e posaçme, evidencat për punëdhënësit dhe përgjegjësitë disiplinore.

Në grupin parlamentar kemi diskutuar për këtë ligj dhe konsideroj që ky projektligj e rregullon në mënyrë të kënaqshme këtë fushë, prandaj e përkrahim dhe kontributin tonë do ta japim gjatë amendamentimit të dytë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Baxhaku! “Vetëvendosjen” nuk e kemi këtu, po ashtu as AAK-në dhe “Nismën”. Lista serbe, urdhëro zoti Simiq.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala, predsedniče!

Poštovane dame i gospodo, narodni poslanici,

Poslanička grupa Srpske liste razmatrala Nacrt zakona o pružanju usluga i mera zapošljavanja nezaposlenima. Ovaj Nacrt zakona je veoma važan, i potrebno je dopuniti ga optimalnim amandmanima, kako bi zakon bio u potpunosti prihvatljiv na drugo čitanje. Zato poziram Funkcionalnu komisiju da ovaj Nacrt zakona optimalno modifikuje. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar “6+”, zoti Danush Ademi e ka fjalën.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Grupi “6+” e ka shqyrtuar Projektligjin për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësim të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve. Besoj që me këtë ligj do të zgjidhet papunësia, sidomos e komuniteteve. Besoj që ndoshta ministri do t’i ketë parasysht, kurse në lexim të dytë do ta japim kontributin tonë.

KRYETARI: Faleminderit! Nuk ka deputetë të paraqitur për diskutim. Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e ka kërkuar fjalën.

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit. Thërras deputetët, regjia t’i bjerë ziles. Deputetët le të vijnë në sallë, ju kisha lutur, ose vazhdojmë me pikat e ardhshme të rendit të ditës, pastaj pas 30 minutash i votojmë të gjitha projektligjet, të cilat i shqyrtojmë, dhe komisioni besoj se do ta përfundojë punën e vet.

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, zotin Arban Abrashi, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin. Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryetar!

Kabinet, ministra, deputetë,

Më lejoni në pika të shkurtra ta prezantoj plotësim-ndryshimin e Projektligjit 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Gjatë zbatimit të Ligjit 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara janë identifikuar vështirësi në implementimin e nenit 12 - punësimi në tregun e hapur të punës, neni 11 - kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për punësim. Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara parasheh ndryshimin e nenit paragrafit 3 dhe 12 për punësimin, kuotat e përcaktuara se çdo punëdhënës është i obliguar ta punësojë një person me aftësi të kufizuara në çdo 50 punëtorë.

Punëdhënësi i cili nuk i përmbush detyrimet, obligohet që të paguajë në vijën buxhetore të Buxhetit të Kosovës kontribute mujore në pagën minimale të realizuar në Kosovë me hapjen e një xhirollogarie të veçantë në buxhetin qeveritar, të dedikuar ekskluzivisht për aftësimin, riaftësimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, ku punëdhënësi do ta paguajë shumën apo kontributin në rastin kur nuk e përmbushin obligimin ligjor për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Këto mjete do të dedikohen ekskluzivisht për aftësimin, riaftësimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Duke pasur parasysh rrethanat ekzistuese në Kosovë, ne synojmë që nëpërmjet këtij plotësim-ndryshimi të themelohet një ambient më pozitiv dhe më i qëndrueshëm për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Çështjet kryesore, të cilat janë adresuar në procesin e plotësim-ndryshimit të këtij ligji, janë: krijimi i mundësive më të mira për aftësim, riaftësim profesional dhe punësim të personave me aftësi të kufizuara, ndryshimi i kuotës prej 1% të pagës minimale e ligjit në fuqi në një pagë minimale për çdo muaj. Kjo u dedikohet punëdhënësve të cilët nuk arrijnë të punësojnë një person me aftësi të kufizuara në çdo 50 punëtorë.

Hapja e një xhirollogarie të veçantë në buxhetin qeveritar, të dedikuar ekskluzivisht për aftësimin, riaftësimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, në të cilën punëdhënësit do ta paguanin shumën apo kontributet me rastin kur nuk e përmbushin obligimin ligjor.

Vlerësimin e aftësisë së mbetur për punë dhe mundësitë për punësim apo mbajtjen, ruajtjen e punës, përfshirë kriteret mjekësore, sociale dhe kriteret tjera të cilat përcaktojnë mundësitë dhe aftësinë e personave me aftësi të kufizuara për inkadrimin e domosdoshëm të tyre në tregun e punës. Si dhe ngritja e vetëdijes së personave me aftësi të kufizuara dhe opinionit në përgjithësi përkitazi me mundësitë potenciale për aftësim, riaftësim profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Meqenëse është fjala për një akt ligjor, i cili do t'i rregullojë dhe përcaktojë të drejtat për punësimin e kësaj kategorie të qytetarëve, ju ftoj që ta aprovoni këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit! Tani, pas këtij prezantimi të projektligjit, e hap debatin për diskutim në parim.

Fjalën e ka kryetarja e Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, zonja Flora Brovina.

FLORA BROVINA: Faleminderit! Ky ligj, sa është ligj social, aq është edhe ligj që garanton të drejtat e njeriut dhe barazon të drejtat e personave me aftësi të kufizuara që të jenë të barabartë në tregun e punës.

Pra, është ligj shumë i rëndësishëm për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Në mandatin e kaluar, Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka monitoruar qendrat e aftësimin profesional dhe ofrimit të mundësive për personat me aftësi të kufizuara dhe ka dhënë një mori vërejtjesh, të cilat fatmirësisht janë marrë në shqyrtim gjatë përpilimit dhe plotësim-ndryshimit të këtij ligji.

Ne besojmë se Komisioni Funkcional për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale do ta studiojë këtë ligj dhe do të japë edhe vërejtje të tjera, duke e analizuar pra edhe përfundimin e monitorimit të këtij ligji, që ai të jetë sa më funksional dhe në favor të personave me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, flas edhe në emër të grupit parlamentar, i cili pajtohet dhe propozon që të votohet ky projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Brovina! Tash fjalën e ka zonja Njomza Emini, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Kolegë deputetë,

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah në parim.

Çështjet kryesore të trajtuara të plotësimit, siç e tha edhe ministri Arban Abrashi, është avancimi i bazës ligjore për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, në përputhje me normat dhe praktikat ndërkombëtare, duke mbrojtur dhe promovuar liritë dhe të drejtat themelore të tyre në kontekstin të tregut të punës. Çështjet kryesore, të cilat janë adresuar në plotësimin e ndryshimit të këtij ligji, janë: krijimi i mundësive më të mira për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, në harmoni me ofertën dhe kërkesën në tregun e punës.

Ndryshimi i kuotës prej 1% të pagës minimale e ligjit në fuqi, në një pagë minimale për çdo muaj. Kjo u dedikohet punëdhënësve, të cilët nuk punësojnë një person me aftësi të kufizuara në çdo 50 punëtorë.

Kryetar, njëkohësisht kërkoj edhe vëmendjen e kolegëve...

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Unë e di se sot nuk ka qenë ditë e lehtë, në qoftë se keni nevojë shkojmë në pauzë sa të dëshironi, përndryshe kisha kërkuar që të ketë qetësi të paktën.

NJOMZA EMINI: ...meqë po flasim për një kategori, mendoj që kemi nevojë për një vëmendje dhe u apeloj edhe kolegëve tjerë që të dëgjojnë...

KRYETARI: Ke të drejtë plotësisht. Faleminderit!

NJOMZA EMINI: Ngritja e vetëdijes së personave me aftësi të kufizuara dhe opinionit në përgjithësi përkritazi me mundësitë dhe potencialet për aftësim, riaftësim profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës konsideron se ky projektligj e rregullon në mënyrë të kënaqshme këtë fushë, prandaj e përkrahim dhe do ta votojmë projektligjin në parim dhe kontributin tonë do ta japim ndërmjet dy leximeve gjatë amendamentimit të tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani nga Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe “Nisma” nuk kemi prani. Lista serbe? Urdhëro, zoti Simiq.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala, predsedniče!

Poslanička grupa Srpske liste razmatrala je Nacrt zakona koje nam je Komisija za rad i socijalna staranja stavila, dakle Zakona o osposobljavanju, stručnoj prekvalifikaciju i zapošljavanju osoba sa ograničenim sposobnostima. Poslanička grupa Srpske liste daće podršku ovom Nacrtu zakona, i pozivamo sve prisutne poslanike da u načelu usvojimo ovaj zakon. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar “6+”, fjalën e ka zoti Danush Ademi.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Grupi “6+” e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe në parim do ta përkrahim këtë projektligj, kurse kontributin tonë do ta japim në leximin e dytë.

KRYETARI: Faleminderit! Kemi deputetë të lajmëruar për diskutim. Zonja Salihe Mustafa e ka fjalën.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe pas lodhjes dhe atyre që përjetuam, mendoj se kjo kategori meriton që ne si deputetë të diskutojmë për këtë projektligj në mënyrë që komisioni gjatë dy leximeve t’i marrë parasysh vërejtjet tona.

Të nderuar kolegë,

Ligji për aftësimin, riaftësimin dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara është monitoruar në legjislaturën e kaluar nga Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Një ndër rekomandimet e komisionit ka qenë që ky ligj të plotësohet dhe ndryshohet, sepse ligji në fuqi ka mangësi dhe në shumicën e rasteve nuk është zbatuar për shkak të metave në ligj. Shumica e rekomandimeve të komisionit janë të përfshira në këtë projektligj, por ajo që është me rëndësi mendoj se është ndryshimi i nenit 12, paragrafi 3.

Sipas këtij neni, punëdhënësi që nuk i përmbush detyrimet nga paragrafi 1 dhe 2 të nenit 12, që domethënë nuk e punëson një person me aftësi të kufizuara në çdo 50 të punësuar, obligohet që për nxitje të punësimit të personave me aftësi të kufizuara ta paguajë në një llogari të veçantë në vijën buxhetore të buxhetit të Kosovës pagën mujore në lartësinë e shumës së pagës minimale të realizuar në Republikën e Kosovës për çdo person me aftësi të kufizuar, që do të duhej të kishte punësuar, e që në ligjin në fuqi është se punëdhënësi që nuk i përmbush këto detyrime do të paguajë vetëm 1% të shumës së pagës mujore.

Gjithashtu, është shumë me rëndësi edhe plotësimi i nenit 13, paragrafi 3, sipas të cilit personi me aftësi të kufizuara vetëm me pëlqimin dhe nënshkrimin e tij mund të punojë natën, jashtë orarit të punës, ose me orar të ndryshuar në harmoni me vlerësimin e komisionit mediko-social, i cili e ka përcaktuar nivelin e aftësisë për punë. Në paragrafin 1.4 mendoj se ka nevojë të

qartësohet më shumë, e kur thuhet “komisioni mediko-social” nënkupton ekipin e përbërë nga ekspertët mjekësorë dhe të fushave të tjera, i themeluar nga institucioni përkatës.

Zoti ministër, unë nuk e kam të qartë cili është institucioni përkatës dhe cilat janë ato fusha të cilat janë të parapara të përfshihen në komisionin mediko-social. Gjithashtu, mendoj se do të ishte mirë që sipas mundësive me këtë ligj të rregullohet që punëdhënësit që punësojnë persona me aftësi të kufizuara të stimulohen me mundësitë e buxhetit sa na lejon, por të gjendet një mundësi që të stimulohen në mënyrë që të punësojnë persona me aftësi të kufizuara sa më shumë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Mustafa! Tani fjalën e ka deputeti Ali Sadriu.

ALI SADRIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

E përshëndes iniciativën për hartimin e këtij projektligji dhe në pika të shkurtra do ta jap kontributin tim që këto mjete, të cilat do të ndahen edhe nga kompanitë private dhe ato shoqërore, të mos shkojnë në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, por të shkojnë direkt në Fondin për Mirëqenie Sociale.

Pra, pagat të cilat duhet t’i paguajë kompania, e cila nuk ka punësuar, të mos i paguajë në buxhet, por t’i paguajë në buxhetin me dedikim për mirëqenien sociale.

KRYETARI: Ok! Në shqyrtimin e dytë të kihet parasysh kjo vërejtje. Deputeti Bislim Zogaj, e ke kërkuar fjalën. Aktivizoje folësin! Mirë Nait, nuk ka nevojë të vraposh se je dhëndër i Komoranit, ai flet vetë, deputet është. Është deputet i ri. Faleminderit!

Përfaqësuesi i Qeverisë nëse e kërkon fjalën. Atëherë, edhe kjo pikë e rendit të ditës kalon në votim më pastaj.

13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet strategjike në Republikën e Kosovës

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministren e Tregtisë dhe Industrisë, zonjën Hykmete Bajrami, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: I nderuar kryetar!

Kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që në emër të ministrisë, të cilën e drejtoj, si bartëse e këtij projektligji, shkurtimisht ta paraqes arsyen, qëllimin, rëndësinë dhe fushën e rregullimit të Ligjit për investimet strategjike në Republikën e Kosovës. Synimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës ka qenë dhe është procedimi i përshpejtuar i pakos legjislative dhe reformës administrative në funksion të përmirësimit të ambientit të biznesit.

Aktualisht institucionet e Republikës së Kosovës kanë vështirësi të shumta për të nxitur dhe tërhequr investime strategjike, vendëse dhe të huaja. Këto vështirësi janë si pasojë e procedurave të pafavorshme, të gjata dhe të komplikuar për realizimin e investimeve të huaja në Kosovë dhe procedurave të komplikuar për bartjen e të drejtës në shfrytëzim të pronës së Republikës së Kosovës tek investitorët.

Vendet fqinja me të cilat Republika e Kosovës është në garë të drejtpërdrejtë sa i përket tërheqjes së investimeve të huaja kanë legjislacion më të favorshëm në krahasim me vendin tonë. Kjo për shkak se legjislacioni i këtyre vendeve parasheh procedura më të thjeshta për bartjen në shfrytëzim të pronës shtetërore tek investitorët e huaj dhe atë me çmime simbolike, pa pasur nevojë për hapjen e procedurave tenderuese.

Pasi ky projektligj të hyjë në fuqi, legjislacioni i Kosovës për investime strategjike do të përfaqësohet me legjislacionin e vendeve fqinje në region dhe njëkohësisht do të eliminohen pengesat për tërheqjen e investimeve të huaja.

Objektiv kryesor i këtij projektligji është krijimi i bazës ligjore të mirëfilltë për nxitjen dhe mbështetjen e investimeve të huaja strategjike në Kosovë, në fushat ekonomike të vendit që paraqesin potencial të lartë zhvillimor. Nëpërmjet këtij projektligji përcaktohen procedurat dhe rregullat favorizuese, lehtësuese dhe përshpejtuese në funksion të arritjes së qëllimit kryesor për nxitjen dhe tërheqjen e investimeve të huaja në Republikën e Kosovës.

Ky projektligj do të zbatohet për të gjitha investimet strategjike që përzgjidhen si të tilla në bazë të kriterëve, të cilat janë të përcaktuara në ligj nëpër sektorë të ndryshëm të investimeve. Nëpërmjet stimulimit të investimeve strategjike do të mobilizohet kapitali financiar, i cili do ta mbështesë zhvillimin e veprimtarisë prodhuese sipas sektorëve të paracaktuar në projektligj.

Ligji ka kaluar nëpër të gjitha procedurat e konsultimit publik edhe brenda institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës me institucionet ndërkombëtare dhe organizatat e ndryshme.

Ne presim që ky ligj të shqyrtohet dhe të miratohet sot në këtë seancë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Faleminderit, zonja ministre Bajrami!

Pas prezantimit të projektligjit, hap debatin për diskutim në parim. Kryetari i Komisionit Funkcional, zoti Muhamet Mustafa.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

I nderuari kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka mirëpritur këtë ligj, e ka konsideruar si një dokument shumë të rëndësishëm që mund ta nxisë aktivitetin investues në Kosovë, vëllimin dhe cilësinë e investimeve në Kosovë për shkak se vendi ynë ka shumë nevojë, sepse niveli i tashëm i aktivitetit investues, sidomos i sektorit privat, është nën nevojat për gjenerimin e vendeve të punës dhe rritjes ekonomike.

Prandaj, komisioni e konstaton këtë ligj si një nga më të rëndësishmit për realizimin e projeksioneve të rritjes ekonomike dhe programeve qeveritare.

Komisioni e ka debatuar me kujdes këtë ligj dhe ka konsideruar se në debatin e mëtejshëm në këtë projektligj është e nevojshme të shihet një përkufizim më i qartë se kush mund të konsiderohet investitor strategjik dhe cilat janë kriteret për ta përcaktuar këtë status, është vetëm shuma e investuar dhe sektori, apo për ne është më me rëndësi që profili i investitorit strategjik të jetë një investitor që ka emër, që e ka një histori të lartë të normave dhe standardeve etike të biznesit dhe që krijon një diferencë dhe e përmirëson imazhin e Kosovës për investitorë.

Gjithashtu, është theksuar se sa është e nevojshme që të shkohet kështu në detaje për sektorë. Po ashtu, do të jetë i nevojshëm një precizim më i mirë i disa fazave të procesit, procese gjatë aprovimit të investimeve strategjike, në mënyrë që të evitohen detajet e panevojshme dhe pengesat që mund të jenë të karakterit burokratik.

Komisioni do ta vazhdojë aktivitetin gjatë leximit të dytë me aktorët e interesuar. Ndonëse ka pasur një interesim shumë të madh për këtë ligj, siç tha edhe ministria, ky ligj është diskutuar shumë prej komunitetit të biznesit, megjithatë ne do të kemi edhe dëgjime publike me investitorë të jashtëm, investitorë potencialë, por edhe me eksplorimin e përvojave në rajon, sepse ministria tha se të gjitha rajonet kanë zgjedhje të ndryshme dhe të shohim me kujdes cilat janë ato zgjedhje që kanë dhënë rezultate dhe cilat nuk kanë dhënë rezultate dhe, në përgjithësi, ne e kemi mbështetur këtë ligj dhe mendojmë se bashkarish dhe në bashkëpunim të aktorëve të interesuar deri në leximin e dytë do të shohim se sa ka dhe për çka do të jetë i nevojshëm ndonjë amendament eventual. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Deklarimet në emër të grupeve parlamentare. Për Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryesues!

Përsëritje Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë dhe

Ju të pranishëm.

Më vjen mirë që sot e kemi në rend dite një projektligj shumë të rëndësishëm, i cili bashkërisht me ligjin që e aprova më parë, Ligjin për prokurimin publik, edhe Ligji për investime strategjike në Republikën e Kosovës e avancojnë çështjen e Kosovës.

Në të njëjtën kohë shpreh keqardhje që kolegët tanë opozitarë e vetëpërkushtuan vetveten nga ky kontribut, të cilin kanë pasur mundësi ta japin në këto pika të rëndësishme të rendit të ditës, që i kemi sot. Pavarësisht kësaj, ne si deputetë që e kemi marrë besimin e qytetarëve jemi të obliguar që në çfarëdo rrethane të vazhdojmë ta plotësojmë besimin e tyre dhe ky ligj, përveç se josh investitorët e huaj, për të cilat Kosova ka jashtëzakonisht nevojë, hap edhe vende të reja të punës për të cilat jemi zotuar para qytetarëve.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka analizuar me shumë vëmendje ligjin në fjalë dhe e ka analizuar edhe aspektin se duhet të kemi rishikim të sektorëve prioritarë strategjikë, precizim

më të mirë të fazave të procesit gjatë aprovimit të investimeve strategjike. Ky ligj e përmirëson në një masë të madhe edhe klimën e të bërit biznes në Kosovë dhe ne si grup parlamentar kontributin tonë do ta japim gjatë fazës së amendamentimit. E votojmë në parim.

I ftoj të gjitha ata, të cilët janë të interesuar dhe mund të na ndihmojnë gjatë fazës së amendamentimit të Ligjit për investimet strategjike në Republikën e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Për Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike, e doni fjalën? Grupi “Vetëvendosje” nuk është këtu, Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk është. Grupi Lista serbe? Fjalën e ka Slavko Simiq.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala, presedajući!

Poštovane dame i gospodo, narodni poslanici,

Poslanička grupa Srpske liste razmatrala je Nacrt zakona o strateškim investicijama, i mi ćemo glasati protiv ovog Nacrt zakona. Prvenstveno, jer zakon u ovom obliku potpuno zanemaruje prava nevećinskih zajednica, propisana niz međunarodnih instrumenata, kao što je na Okvirna konvencija Saveta Evrope o zaštiti nacionalnih manjina, koje se direktno primenjuju na Kosovo, kao i odgovarajućih odredbi u Ustav Kosova koje štite prava i interesa zajednica.

Pored toga Zakona o strateškim investicijama je u sukobu sa drugim zakonima koju uređuju oblast privatizacije. Zakon takođe narušava imovinska prava zagarantovana Ustavnom Kosova i međunarodnim instrumentima koje se primenjuju na Kosovo. Poput konvencije Saveta Evrope o zaštiti ljudski prava i osnovnih slobode za protokolima i u velikoj meri dovodi u pitanje mogućnost ostvarivanja restitucije na Kosovo.

Zato Poslanička grupa Srpske liste neće podržavati ovaj Nacrt zakona i mi ćemo osnovnu verziju revidirati amandmanima između prvog i drugog čitanja kroz Funkcionalnu komisiju za Ekonomski razvoj, infrastrukturu, trgovinu i industriju. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin “Nisma”, s’ka. Grupi “6+” nuk është paraqitur, atëherë besoj Danush Ademi për Grupin “6+”. Urdhëro!

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Grupi “6+” ka shqyrtuar Projektligjin për investimet strategjike në Republikën e Kosovës dhe në parim do ta përkrahë këtë projektligj.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Kalojmë në diskutimet e deputetëve. Fjalën e kanë kërkuar sipas kësaj radhe, Agim Aliu, pastaj Ramiz Kelmendi.

AGIM ALIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Kryeministër, zëvendëskryeministër,

Kabinet qeveritar,

Është shumë mirë që sot Kuvendi i Republikës po kalon në agjendë zhvillimi dhe në agjendën e vërtetë, e cila do të duhej të jetë pjesë e punës dhe angazhimeve si Kuvend i Republikës, dhe po ashtu është shumë mirë që ne sot e kemi në shqyrtim në lexim të parë Projektligjin për investimet

strategjike të Republikës së Kosovës, e që është tejet i nevojshëm në sferën e krijimit të mundësive për zhvillimin e projekteve strategjike të konsideruara si tejet imediate për zhvillimin e gjithmbarshëm të shtetit tonë, duke ndikuar kështu në përmirësimin e kushteve dhe standardeve të prodhimit të mallrave, ofrimit të shërbimeve dhe në përmirësimin e përgjithshëm të standardit jetësor të qytetarëve tanë dhe në mbrojtjen e ambientit.

Si dhe do të inkurajojë futjen në përdorim të teknologjive të përparuara, të cilat do të ndikojnë në ngritjen e konkurrencës dhe efikasitetit të ekonomisë së Republikës së Kosovës, si dhe në uljen e deficitit tregtar.

Projektligji në fjalë hap rrugë dhe ofron mundësi për të gjithë të interesuarit, pavarësisht statusit të tyre, që ta investojnë kapitalin e tyre në zhvillimin e projekteve strategjike duke mundësuar kështu shfrytëzimin e resurseve natyrore humane që ka shteti ynë në funksion të zhvillimit dhe ngritjes së tyre në aspektin e profitit, në funksion të punësimit, e gjithsesi në funksion të zhvillimit të gjithmbarshëm të Republikës sonë. Por, përpos asaj që ka si përparësi, ky projektligj në fazën e jetësimit të tij si ligj konsideroj se i ka disa të meta, prandaj propozoj që të ketë edhe disa ndryshime në fazat e tij, të cilat besoj që do ta pasuronin edhe më tej këtë projektligj, të cilësuar tashmë si tejet të rëndësishëm.

Konsideroj se duhet të shikohet mundësia që të bëhet decentralizimi i procesit implementues të këtij ligji, që t'u japim më shumë kompetenca kryetarëve të komunave, e jo vetëm si pjesë e komisionit ndërministror, që ta kenë mundësinë e përcaktimit dhe zhvillimit të projekteve strategjike duke ndërtuar interaksion me nivelin qendror, apo Qeverinë e Republikës së Kosovës nëpërmjet Agjencisë për Investime dhe atë në aspektin e konsultimeve, si dhe ato administrative që lidhen me nivelin qendror.

Ky propozim lind dhe nga fakti se Ligji për partneritetin publiko-privat në sajë të centralizimit të procesit implementues pothuajse shumë pak apo fare nuk ka mundur të implementohet nëpër komunat e Republikës së Kosovës për zhvillimin e projekteve të ndryshme infrastrukturore.

Gjithashtu, konsideroj se duhet të shikohet mundësia e ngritjes, apo e rritjes së afatit të shfrytëzimit të pronës publike nga investitorët nga 40 vjet, e propozuar në këtë projektligj, në 99 vjet, sepse vetëm kështu ne e bëjmë ofertën tonë joshëse ndaj investitorëve të huaj e të brendshëm për financimin e projekteve të cilësuar si strategjike. Të shikohet po ashtu mundësia e lehtësimit përmbajtjesor të kërkesave për marrjen e statusit “investim strategjik”. Te disa projekte strategjike të shikohet mundësia e uljes së pragut investues financiar me kriteret e përcaktuara me nenin 4 të këtij projektligji, konkretisht te projektet strategjike që kanë të bëjnë me trajtimin dhe riciklimin e mbeturinave, të jetë prag investues më i ulët, në mënyrë që të ngritët konkurrenca investimore në këtë fushë, nga 10 milionë në 3 milionë vlerë investimi.

Krejt në fund, e përgëzoj edhe një herë sponsorizuesin e këtij projektligji - Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, respektivisht Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe në të njëjtën kohë, duke inkurajuar vazhdimin e hartimit edhe të projektligjeve të tjera, të cilat drejtpërdrejt do të ndihmonin zhvillimin e gjithmbarshëm të shtetit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ramiz Kelmendi e ka fjalën.

RAMIZ KELMENDI: I nderuar kryesues!

Kabinet qeveritar,

Kolegë deputetë,

Ligji për investime strategjike parasheh një bashkëbisedim të aktorëve ekonomikë me Qeverinë është njëfarë baraspeshe që po tentohet të vendoset ndërmjet shteteve të regjionit, por për mendimin tim më mirë do të kishte qenë ndryshim-plotësimi i ligjit, i cili ka krijuar barriera të shumta për çdo aktor ekonomik, e sidomos për ata të cilët dëshirojnë të qasen në ekonomi.

Pra, nuk duhet të vazhdojnë ligjet ekzistuese që po e pengojnë zhvillimin ekonomik. Duhet përmirësuar që të jetë në funksion për të gjithë aktorët ekonomik. Çdo investitor që e punëson veten apo dikë tjetër për momentin dhe për Republikën e Kosovës është investitor strategjik.

Pse duhet t'i diskriminojmë ndoshta investitorët potencialë, vendorë apo ekzistues, që mund shumë më tepër të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të Kosovës sesa të tjerët. Pra, unë nuk jam kundër investitorëve të huaj dhe trajtimit të tyre profesional, por jam për të ndryshuar ligji që të jetë për të gjithë aktorët që dëshirojnë të kontribuojnë zhvillimin ekonomik dhe ta rritin punësimin në Kosovë të jenë të barabartë.

Kur i shoh vlerat e investimit, unë mund të ju them se duhet të trajtohen, sepse kemi shumë ekonomi që punësojnë shumë njerëz, por që vlera investuese e tyre është e vogël dhe shpeshherë vlera numerike do të jetë pengesë për një bashkëbisedim të sinqertë ndërmjet aktorëve të rinj ekonomikë dhe vetë komisionit për bisedim. Prandaj, ju kisha lutur që të trajtohet me më shumë kujdes, të trajtohen ligjet ekzistuese që po e pengojnë zhvillimin ekonomik dhe njëkohësisht të avancohet edhe më tutje dhe me vlera edhe më të ndryshme, në mënyrë që të kemi përfitim nga investitorët e jashtëm, e sidomos nga investitorët e brendshëm.

Po e zëmë, nëse një kompani si imja mendon për katër vjetët e ardhshme që të investojë 154 milionë, çka përfiton ajo prej Qeverisë dhe çka i ofrohet një investitori të tillë, i cili mendon me 154 milionë të punësojë diku rreth 2 mijë veta dhe si bisedohet me aktorët ekzistues në raport me aktorët e jashtëm? Ne e kemi një traditë jo fort të mirë. Zakonisht aktorët e huaj i vlerësojmë shumë më tepër, i pranojmë në bashkëbisedim shumë më lehtë dhe shpeshherë me ndikimin e njerëzve - ambasadorëve të jashtëm, veprohet dhe shumë herë jepet pasuria publike më shpejt sesa aktorëve vendorë.

Prandaj, unë e kisha ftuar Komisionin Funksional që ta shqyrtojë edhe një herë detajisht dhe t'i eliminojë të gjitha barrierat që po pengojnë zhvillimin ekonomik. Neve na nevojitet që të rinjtë e Kosovës, të cilët kanë nevojë për mbështetje, si nga prona, ashtu edhe nga mjetet financiare, të jenë më të pranishëm se sa ndoshta aktorët tjerë të jashtëm, të cilët ne po presim dhe i ftojmë me këmbëngulësi, por ata nuk janë kurrkund në pamje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në ndërkohë, deputeti Muhamet Mustafa e ka kërkuar fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e dëgjova me vëmendje deputetin Kelmendi. Sa e kam kuptuar ligjin, ai i trajton njësoj investitorët, nuk i dallon ndërmjet investitorëve që vijnë nga jashtë dhe investitorëve nga sektori privat vendor. Por, në qoftë se ka elementet të tilla të çfarëdo diskriminimi, ne do t'i eliminojmë

bashkërisht. Përkundrazi, duhet edhe investitorët vendorë që kanë kontribuar, edhe tash, edhe të ardhmen, t'u hapet mundësia që të përfitojnë nga ky ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar ministrja, zonja Hykmete Bajrami.

MINISTRJA HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, nënkryetar!

Dola këtu vetëm sa për të dhënë disa shpjegime. Fillimisht deputeti Simiq i dha tri vërejtje. Tha se ligji i cenon të drejtat e pakicave, gjë që absolutisht nuk është e vërtetë, sepse i trajton njëjtë, siç e tha kryetari i komisionit, profesori Muhamet Mustafa, si investitorët vendorë, ashtu edhe investitorët e huaj.

Nuk ka kurrfarë cenimi të të drejtave të pakicave me këtë ligj.

Gjithashtu, përmendi një vërejtje tjetër se cenohen të drejtat pronësore. Dua ta bëj të qartë këtu se ligji nuk e ka paraparë në asnjë formë bartjen e pronës private tek investitorët e huaj. Dhe, tha se është në konflikt me ligjet e tjera. Më lejoni të ju tregoj që nuk është në konflikt me ligjet e tjera dhe ligje të tilla kanë vendet të cilat janë anëtare të Bashkësisë Evropiane dhe ato të cilat kanë avancuar shumë më tepër se ne. Ligje dhe dispozita të tilla kanë Kroacia, Bullgaria, Malta, ndërkohë që një ligj të tillë e ka aprovuar Shqipëria në vitin e fundit dhe kemi njohuri për një sërë projektesh të cilat me negociatat e drejtpërdrejta u janë dhënë investitorëve në Serbi.

Tani, sa i përket komentit të deputetit Aliu, i cili përmendi që duhet t'u jepet më shumë kompetenca komunave dhe kryetarëve të tyre, besoj që është kompetencë me vetë faktin se kryetarët i komunave janë anëtarë të Komisionit Ndërmjësor, në të cilin potencialisht do të zhvillohet projekti dhe gjithashtu ne e kemi në plotësim-ndryshim, domethënë është në strategjinë legislative për vitin 2016 Ligji për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, i cili është thënë prej shumë kryetarëve të komunave dhe prej vetë Asociacionit të Komunave se ky ligj paraqet pengesë.

Ndërsa, deputetit Kelmendi, e thamë disa herë që është një trajtim i barabartë ndërmjet investitorëve të huaj dhe të brendshëm, ndërsa sa u përket ligjeve të tjera ne besojmë se kemi bërë shumë ndryshime vitin e kaluar dhe agenda zhvillimore do të vazhdojë edhe këtë vit. Ju e dini që janë ndryshuar ligjet e pakos fiskale, e kemi ndryshuar Ligjin e prokurimit, ka filluar domethënë prokurimi elektronik me pilot-projekte. Jemi në diskutim e sipër të udhëzimit administrativ për t'i ofruar pushimet tatimore, si për investitorët, që për herë të parë investojnë për projektet e reja, edhe për ata ekzistues.

Dua t'ju bëj të qartë që për Qeverinë e Republikës së Kosovës aspak më të rëndësishëm nuk janë investitorët e rinj, ose investitorët e huaj, sesa investitorët të cilët punësojnë me mijëra punëtorë për momentin dhe besoj që tashmë e kemi dëshmuar këtë edhe nëpërmjet reformimit dhe heqjes së shumë barrierave nëpërmjet Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik.

Andaj, ju lus që sot ta votoni në lexim të parë këtë ligj dhe mandej natyrisht që komisioni është shumë kooperativ dhe sigurisht do t'i marrë të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e juaja. Unë mendoj që ju mund ta bëni draftin të cilin e kemi dorëzuar një ligj shumë më perfekt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja ministre! E kryem diskutimin për këtë ligj, siç u morëm vesh do ta votojmë pak më vonë. Kalojmë në pikën e 14-të të rendit të ditës:

14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kundërvajtje

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

I nderuari kryeministër, zëvendëskryeministra,

Anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që para jush ta paraqes për miratim Projektligjin për kundërvajtje, i cili ka për qëllim, ndër të tjera, që t'i arrijë këto synime: reformimin e thellë të fushës në kundërvajtje dhe rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit në shqyrtimin dhe zgjidhjen e lëndëve për kundërvajtje.

Nëpërmjet këtij projektligji do të arrihet një reformë substanciale në fushën e kundërvajtjes ku parashihej, ndër të tjera, heqja e dënimit me burgim për kundërvajtje dhe mundësia që për një numër të caktuar të veprave për kundërvajtje të shqiptohen gjoba nga organet kompetente të ligjit, duke përcaktuar maksimumin dhe minimumin e sanksioneve për kundërvajtje.

Po ashtu, është dhënë mundësia e takimit të vendimeve brenda organeve të instancës së parë dhe asaj të dytë dhe të jepet mundësia e shterimit të mjeteve të drejta të atakimit të vendimit të gjykatave kompetente, duke hapur edhe konfliktin administrativ. Ky projektligj po ashtu përcakton edhe parimet e përgjithshme për kundërvajtje dhe obligime që aktet tjera që i përcaktojnë kundërvajtjet të jenë në harmoni të plotë me dispozitat e ligjeve në fuqi.

Më lejoni t'ju them që është përcaktuar një formë e veçantë e përmbartimit të vendimeve të formës së prerë duke inkurajuar qytetarët që ata që e kryejnë obligimin në afatin e paracaktuar, dënimi i tyre mund të lirohet deri në 50% nga shuma e gjobës së shqiptuar më herët.

Po ashtu, ky projektligj është në harmoni të plotë edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, duke lejuar mundësinë që të jetë një praktikë e mirë, jo vetëm për vendet me rajon, por edhe me atë që paraqesin në praktikën e vendeve të Unionit Evropian.

Më lejoni të ju them që ky është i ndarë në dy pjesë kryesore, në pjesën që ka të bëjë me pjesë materiale juridike dhe atë procedurale dhe që ka për qëllim gjithmonë të parashohë procedura të veçanta edhe për të miturit në ekzekutimin e sanksioneve për kundërvajtje.

Krejt në fund, më lejoni të ju them që për këtë kemi bërë analiza dhe diskutime të shumta me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, në veçanti me Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Gjykatën Supreme dhe gjyqtarët nga fusha e veçantë që merren me kundërvajtje.

Andaj, duke marrë parasysh propozimin që kemi sot, me mundësi që të jepni ide dhe veprimet tuaja, ju ftoj që ta miratoni në lexim të parë dhe pastaj ta miratojmë në Kuvendin e Republikës së Kosovës si ligj në tërësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër Kuçi! Do ta hapim debatin për diskutim në parim për këtë projektligj. E para e merr fjalën nënkryetarja e Komisionit Funkcional për Legjislacion, deputetja Selviqe Halimi.

SELVIQE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 9.2.2016 e shqyrtoi Projektligjin nr. 05/L-087 për kundërvajtje dhe vendosi, që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-087 për kundërvajtje. Faleminderit!

KRYESUESI: Deklarimet në emër të grupeve parlamentare. Për Grupin Parlamentar të PDK-së, deputeti Agim Aliu e ka fjalën.

AGIM ALIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar nënkryetar,

Kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka shqyrtuar Projektligjin për kundërvajtje dhe do të japë mbështetjen e tij, duke pasur parasysh faktin se është një ligj tepër i rëndësishëm, siç e përmendi edhe ministri. Dhe, duke pasur parasysh se është ligj që po miratohet për herë të parë në Kuvendin e Republikës, sepse deri më tash kjo sferë e drejtësisë është mbuluar me ligje të aplikueshme, prandaj ky ligj ka një rëndësi tejet të veçantë dhe ne do japim kontributin edhe në fazat tjera të amendamentimit, në mënyrë që t'i plotësojë kërkesat që ka drejtësia kosovare.

Prandaj, ftoj deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, si dhe deputetët e Kuvendit që të miratojnë këtë ligj në parim.

KRYESUESI: Faleminderit, zotëri deputet! Për Grupin Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së ka shqyrtuar Projektligjin për kundërvajtje. Tashmë është e ditur edhe nga ajo që u tha nga sponzorizuesi, por edhe nga kolegët tjerë, se ne kemi pasur mungesë të këtij projektligji apo të Ligjit për kundërvajtje, sepse është punuar me ligj të vjetër dhe me Rregullore të UNMIK-ut.

Mendojmë që me këtë projektligj do të kompletohet legjislacioni, që ka të bëjë edhe ajo në harmoni me legjislacionin penal - Kodin Penal, por edhe dallimet që kanë qenë me Ligjin për siguri në komunikacionin rrugor. Andaj, si grup parlamentar mendojmë se ky projektligj duhet të përkrahet, përpos atyre procedurave që kanë të bëjnë edhe me rritjen e efikasitetit, qoftë edhe në zvogëlimin e aksidenteve dhe numrin e lëndëve që janë të pazgjidhura nëpër gjykatat tona. Ne si grup i japim përkrahje në parim.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet! Grupi “Vetëvendosje” nuk është, i Aleancës nuk është, të tjerët... Lista serbe s’është paraqitur, “Nisma” s’është, Grupi “6+” jo. Atëherë... Danush, paraqitu me kohë.

Grupi “6+”, Danush Ademi.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Grupi “6+” e ka shqyrtuar Projektligjin për kundërvajtje dhe kontributin e vet do ta japë në lexim të dytë.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka diskutues të tjerë. Kalojmë në pikën e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës:

15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit Komisioni Funkcional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. Ftoj ministrin e Kulturës, Rinisë dhe të Sportit, zotin Kujtim Shala, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Për të krijuar kushte më të mira në fushën e kulturës, rinisë dhe të sportit, Qeveria në vazhdimësi do të formulojë politika programore dhe do të propozojë akte legjislative, siç është edhe ky projektligj. Rregullimi ligjor i çështjes së sponsorizimeve dhe donacioneve paraqet një dimension me rëndësi të shtyrjes përpara të objektivave tona në lidhje me kulturën, rininë dhe sportin. Me këtë projektligj për herë të parë vihen bazat juridike për trajtimin, rregullimin dhe njohjen e sponsorizimeve dhe të donacioneve në fushat e lartpërmendura.

Me anë të këtij projektligji rregullohen marrëdhëniet, kushtet dhe niveli i lehtësirave financiare nëpërmjet zbritjeve të lejuara për personat fizikë dhe juridikë, të cilët me vullnet të lirë sponsorizojnë apo bëhen donatorë të këtyre fushave me interes të veçantë publik, konkretisht fusha e kulturës, rinisë dhe sportit. Ky projektligj rregullon, përcakton dhe njeh autoritetin e subjekteve, të cilët kanë të drejta dhe detyrime për realizimin e interesit publik të përcaktuar në këtë projektligj, sponsorizimin dhe donacionin, si dhe ndihmesat e veçanta për realizimin e interesit publik, lëndën e sponsorizimit dhe të donacionit bashkë me lehtësirat financiare përmes zbritjeve të lejuara në pajtueshmëri të plotë me kornizën ligjore të nxjerrë nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës, e cila i ka konsideruar si fusha me interes publik me Ligjin nr. 05/L-028 për tatimin e të ardhurave personale dhe Ligjin nr. 05/L-029 për tatimin e të

ardhurave në korporata. Në tërësi ky projektligj krijon lehtësira financiare 20% për sponsorizuesit dhe donatorët.

Dëshiroj të ju njoftoj, se procesi i hartimit të projektligjit ka kaluar të gjitha fazat e konsultimit dhe të komunikimit me publikun, po ashtu përfituesit e mundshëm kanë pasur rastin që t'i japin vërejtjet dhe sugjerimet e tyre. Kemi zhvilluar konsultime dhe komunikim edhe me institucionet tjera relevante, me të cilat kemi harmonizuar qëndrimet dhe politikat tona në funksion të rregullimit sa më të mirë të kësaj çështjeje.

Të nderuar deputetë,

Duke u nisur nga sa u tha, rekomandoj miratimin në leximin e parë të këtij projektligji dhe procedimin e tij të mëtejshëm. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër Shala!

Tash hapim debatin për diskutim në parim. Fjalën i pari e merr deputeti Nait Hasani, kryetar i Komisionit Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje Kabinetit qeveritar!

Komisioni për Arsim, Shkencë, Rini, Kulturë, Sport dhe Diasporë më 9 shkurt e ka shqyrtuar projektligjin dhe kërkon që seanca ta miratojë në parim dhe do të jemi pjesë e komisionit që do ta shqyrtojmë dhe plotësojmë me amendamente të nevojshme.

Mendoj se këtë ligj, sa i përket sportit, kemi pasur nevojë më herët ta kemi, por edhe në këtë kohë besoj se mund t'ia arrijmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet Hasani! Për Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, deputeti Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Është një ligj shumë i rëndësishëm, i cili i ka munguar fushës së kulturës, rinisë dhe sportit. Është mirë që ministria tani ka hartuar këtë projektligj dhe e ka sjellë për miratim. Ne si grup parlamentar e kemi shqyrtuar projektligjin në tërësi dhe mund të them lirisht, që ky ligj, në aspektin e kërkesave të cilat i ka edhe në fushën e kulturës dhe sportit, vlera financiare e përcaktuar dhe e lirimeve financiare nuk i përmbushë nevojat dhe kërkesat e klubeve, federatave dhe shoqatave kulturore, sportive dhe të rinisë.

Prandaj, mendojmë që brenda shqyrtimit nga leximi i parë në leximin e dytë ne të japim kontributin dhe ta plotësojmë këtë ligj, që të jetë më i mirë, në veçanti në këtë fazë, ku sporti kosovar pothuajse ka thyer të gjitha barrierat dhe tani po hapëron drejt rrugës ndërkombëtare dhe këtu do të ketë nevojë për mbështetje financiare, për arsye se nuk do të jetë e mundur që të gjitha klubet sportive, federatat të cilat do të garojnë në garën ndërkombëtare të mbulohen me Buxhetin

e Republikës së Kosovës, por kjo do të japë një mundësi që klubet të zhvillohen dhe ky zhvillim të jetë përmes sponsorizimeve dhe ky sponsorizim, sigurisht se duhet të jetë më i madh, se sa ai që është paraparë me projektligjin e tanishëm, i cili ka ardhur në Kuvend.

Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike i japim përkrahje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për Grupin Parlamentar të LDK-së, deputeti Sali Morina.

SALI MORINA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar me kujdes këtë projektligj, njëkohësisht falënderojmë edhe Qeverinë, kryeministrin, po ashtu edhe ministrin Shala për sjelljen e këtij ligji, sepse është i një rëndësie të veçantë. Ka qenë kërkesë e kamotshme edhe e të rinjve, shoqatave kulturore dhe klubeve sportive që ky ligj të miratohet në Parlamentin e Kosovës dhe mendoj se është në kohën dhe momentin e duhur.

Ne edhe si grup edhe si komision me kujdes do të angazhohemi që në ato të meta që janë të paraqitura deri më tani, të modifikohen dhe të japim kontributin tonë edhe në leximin e dytë dhe besoj se përmes dëgjimeve publike ky projektligj do të modifikohet dhe njëkohësisht të jetë edhe më i implementueshëm dhe në interes të të rinjve të Kosovës, të sportistëve dhe shoqatave kulturore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet!

Nga grupet tjera nuk janë paraqitur, mirëpo e kemi të paraqitur deputetin Raif Qela.

RAIF QELA: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Ky projektligj ka qenë më se i nevojshëm të iniciohet dhe të sillet këtu në Kuvend. Marrë në përgjithësi, ky projektligj plotëson disa fusha të jetës shoqërore, porse e ka një problem. Përderisa hartimi i këtij projektligji do të duhej që të shndërrohej në ligj, domethënë të synojë për ta çliruar dhe fuqizuar tërë potencialin shoqëror për zhvillimin e artit dhe të kulturës, zhvillimin e sportit dhe sektorit të rinisë në Kosovë, duke mos e përcaktuar qartë kufirin ndërmjet asaj se cili është... derisa nuk është e përcaktuar me ligj, se cili është interesi i përgjithshëm publik, lë mundësinë që të centralizohet tepër shumë edhe fusha e artit, duke ofruar zgjidhje që synojnë ta mbajnë të centralizuar dhe të kontrolluar edhe përkrahjen financiare për zhvillim të artit dhe kulturës, sepse me këtë zgjidhje duhet patjetër që të merret, të jepet një vendim, me të cilin vërtetohet interesi i përgjithshëm publik. Një vendim, përmes institucionit, duhet ta marrë secili që do të marrë ndonjë donacion. Me fjalë të tjera, përmes kësaj, ka mundësi që të synohet centralizimi i artit në përgjithësi dhe në veçanti të mos dallohet qartë, se kur ka mundësi që ky të keqpërdoret dhe kur, përmes kësaj rruge, të detyrohet të centralizohet edhe arti. Faleminderit!

KRYESUESI: Në ndërkohë është paraqitur deputetit Shaip Muja. Urdhëro, Shaip!

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë e përkrah plotësisht këtë ligj dhe inkurajoj ministrin, që së paku me vonesë, për dallim prej ministrave të tjerë që kanë ditur të bëjnë PR më të mirë, në formë - pa formë të ligjit, ky ligj besoj se edhe në interesin publik është jashtëzakonisht i fuqishëm dhe neve do të na japë mundësi, që me amendamentimet edhe propozimet që do t'i bëjmë në leximin e dytë do ta kemi më të plotësuar dhe të adresuar në fushën e investimeve në formë të donacioneve për afirmimin e sportit. Është njëra ndër politikat më të mira preventive, qo do të sjellim për interes publik, por edhe për interesin e qytetarëve dhe fëmijëve në veçanti. Prandaj, unë mendoj se me një formë pak më të zgjeruar, ndoshta edhe nga Komisioni, të kihen edhe praktikatat e shteteve të tjera, të cilat konform standardeve që lejon edhe Kosova, të merren dhe të paraqiten në këtë ligj, si formë ligjore që të jepet mundësi për një ligj të qëndrueshëm dhe të avancohet sporti dhe të gjitha disiplinat sportive në Republikën e Kosovës.

Meqenëse, Kosova ka pasur mundësi ta zhvillojë sportin në mënyrë më të mirë e kryesisht edhe Komuna e Prishtinës, qoftë liderët e mëparshëm, por edhe ky i tanishmi, kanë ngecur shumë në këto politika dhe shihet që edhe kryetarit të tanishëm të komunës së Prishtinës i mbeten lekët mjaft në suficit dhe ia merr Qeveria, siç ua kanë marrë kryetarëve të mëparshëm, siç është e ish-kryeministri dhe si ish-kryetar i Komunës, kanë pasur mundësi të investojnë me atë suficit në shumë disiplina sportive, që si kryeqytet të jetë shembull për qytetet tjera të Republikës së Kosovës.

Megjithatë, nëse i kuptojmë këto lëshime që i kemi bërë, të mos i lëshojmë për të ardhmen dhe, ndoshta me ligj të parashihet që pjesa e suficitit që u mbetet edhe organizatave buxhetore ose komunave, ndoshta një pjesë e tyre të dedikohet me ligj edhe në avancimin e drejtorisë së sporteve të komunave, ku janë të pranishme ato njësi buxhetore. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, deputet Muja! Nuk ka të tjerë. Kalojmë në pikën vijuese gjathtëmbëdhjetë:

16. Shqyrtimi i propozim-Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij

Komisioni FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione ka hartuar propozim-Rregulloren për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

E ftoj deputeten Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit FunkSIONAL, që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe arsyetojë propozim-Rregulloren. Urdhëroni!

LIRIJE KAJTAZI: Deputetë,

I nderuar kryeministër dhe ju ministra,

Duke i marrë parasysh obligimet që dalin nga neni 8, paragrafi 12 i Ligjit për Avokatin e Popullit, komisioni vlerësoi se është i nevojshëm hartimi i Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij, për ta bërë qartësimin normues të nenit të lartpërmendur, që është në favor të rritjes së efektivitetit normativ dhe ta lehtësojë zbatimin e këtij ligji në praktikë.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione duke u bazuar në konstatimet e theksuara vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim për të nxjerrë rregulloren, për të miratuar Rregulloren për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të Avokatit të Popullit.

Ju ftoj për miratim. Kështu si është, besoj se është mjaft qartësues. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Atëherë, hap debatin për diskutim. Deputetja Salihe Mustafa, PDK.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka marrë pjesë në hartimin e Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij. Kjo buron nga neni 8, paragrafi 12 i Ligjit për Avokatin e Popullit. Me këtë rregullore përshkruhen saktë procedurat e zgjedhjes së Avokatit të Popullit dhe shkarkimit të tij dhe zëvendësve të tij, kështu që me këtë rregullore, pasi që Ligji për Avokatin e Popullit është miratuar nga Kuvendi, gjithashtu është zgjedhur edhe Avokati i Popullit, me këtë Rregullore i mundësohet Avokatit të Popullit që të shpallë konkursin për zgjedhjen e zëvendësve të tij nga Kuvendi, në mënyrë që ky institucion i rëndësishëm i shtetit tonë të jetë edhe më efikas në punën e tij.

Andaj, ju ftoj që ta votoni! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk kemi paraqitje të tjera të grupeve parlamentare, as të deputetëve. Kalojmë në pikën në vijim:

20. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2016

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2016 dhe, Kuvendit ia rekomandon për miratim.

Fjalën e ka kryetari i Komisionit Funkcional, Naser Osmani, që do ta arsyetojë raportin dhe rekomandimet.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës e ka përmbyllur vitin 2015 me 30 milionë euro kthim neto të mjeteve. Fondi ka filluar vitin 2016 me 1 miliard 290 milionë euro kontribute nën menaxhimin, nga 1 miliard e 148 milionë euro, sa ishin në vitin 2015.

Kthimi i investimeve pritet të jetë 3% gjatë vitit. Kontributet e arkëtuara do të jenë 128 milionë euro, ndërkaq tërheqjet e kursimeve parashihet të jenë 17 milionë euro. Gjatë vitit 2016 është planifikuar që fondi mesatarisht të menaxhojë 1 miliard e 293 milionë euro.

Në pajtim me Ligjin për fondet pensionale të Kosovës Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës i ka propozuar Kuvendit miratimin e taksës operationale prej 0,082% dhe miratimin e taksës

investive prej 0,398%. Mbështetur në këto propozime Buxheti i Fondit për vitin 2016 është miratuar në shumë prej 6 528 379 euro. Për aktivitetet operacionale janë planifikuar 1 384 316 euro dhe për aktivitetet investive 5 144 063 euro.

Taksa investive e propozuar është 0,003% më e ultë se në vitin 2015, që është miratuar atëherë me 0,40%, shpenzimet investive janë të lidhura me kosto që ngarkojnë menaxhuesit e fondeve investive, apo aset-menaxherët, përmes të cilëve fondi investon mjetet pensionale.

Fondi ka planifikuar që mjetet t'i investojë aset-menaxherë të ndryshëm, me qëllim të diversifikimit të riskut dhe mbrojtjes më të madhe të mjeteve në rast të rënies së tregjeve financiare. Ndërsa, taksa operacionale e propozuar është për 0,002% më e ulët se në vitin e kaluar. Shpenzimet operacionale janë të lidhura me aktivitetet e brendshme operacionale, që i zhvillon fondi.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar dhe analizuar kërkesën për miratimin e taksës vjetore dhe buxhetin e Fondit të kursimeve pensionale të Kosovës dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e kërkesës së Fondit dhe caktimin e taksës operacionale prej 0,082% dhe taksës investive prej 0,398% për vitin 2016.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka për Grupin e PDK-së, deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës Ka shqyrtuar kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për taksën vjetore për vitin 2016. Pas shqyrtimit që i ka bërë taksës vjetore, ka shqyrtuar, ka përkrahur rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, që të miratohet taksa vjetore. Njëkohësisht, u sugjeroj dhe rekomandoj deputetëve që të miratojnë kërkesën e Fondit për caktimin e taksës operacionale për 0,082% dhe taksën vjetore prej 0,398% për vitin 2016. Faleminderit!

KRYESUESI: Nuk ka diskutues të paraqitur për këtë problematikë. Unë kërkoj që të ftohen deputetët të vijnë në votime! Shefat e grupeve...

(Ndërprerje e incizimit)

Deputetë të nderuar,

Tash do t'i votojmë projektligjet dhe projekt-rregulloret, të cilat i diskutuam deri më tash. Në sallë janë 62 deputetë. Ju lus që të votoni të gjithë pa marrë parasysh qysh votoni, sepse votimi është i vlefshëm kur votojnë 61.

Kush është pa kartelë le të lajmërohet, mund të votojë me dorë, por le të tregojë.

Atëherë, votojmë - Shqyrtimin e parë të **Projektligjit për regjistrim dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuesve dhe punëdhënësve**. Votojmë tash!

Gjithsej 62 vota janë për, asnjë kundër, asnjë abstenim. Atëherë, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkesve dhe punëdhënësve.

Kërkohet nga Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregullore të Kuvendit ta shqyrtojë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesë raport me rekomandime.

Tash e votojmë ***Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar***. Votojmë tash!

Gjithsej 61 votë për, 0 kundër, 0 abstenim, Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar.

Kërkohet nga Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregullore të Kuvendit të shqyrtojë projektligjin dhe t'i japë raportet dhe rekomandimet Kuvendit.

Ju lutem, votojmë - ***Shqyrtimin e parë të Projektligjit për investimet strategjike në Republikën e Kosovës***. Votojmë tash!

Gjithsej 60 vota janë për, 2 janë kundër, 0 abstenime. Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për investime strategjike në Republikën e Kosovës.

Kërkohet nga Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme, që në afat të paraparë me Rregullore të Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i japin raportet me rekomandime.

Ju thërras që ta votojmë ***Projektligjin për kundërvajtje***. Votojmë tash!

Voto edhe një njeri, voto edhe një, votoni si të doni, “për” apo “kundër”, por le të votojë edhe një! Ju lus, 60 vota janë, të gjitha janë “për”, por duhet një 61-sh sipas interpretimeve të njëfarë gjykate të famshme. Unë ju them, kush është që do të votojë. Edhe njëherë e votojmë të njëjtën gjë. Votojmë sërish!

Ky projektligj parëz i ka fituar 60 vota të gjitha, tash i ka fituar 56 vota. Edhe është kaq, di t'ju them ju, s'ka të tretë e të vërtetë, cila e tretë e vërtetë? Kalojmë tutje! Kaq i ka marrë, Ligji le të kallëzojë!

Shqyrtimi i parë i ***Projektligjit për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit***, bëhuni gati të votoni. Votojmë tash!

Kanë votuar për 61 deputetë, një është kundër. Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Kërkohet nga Komisioni

Funksional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportet me rekomandime.

Tash ju lutem, bëhuni gati ta votojmë - ***Propozim-Rregulloren për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të popullit dhe zëvendësve të tij***. Bëhuni gati për votim! Votojmë tash!

Atëherë, 61 vota janë për, nuk ka abstenime, nuk ka kundër. Kuvendi miratoi Rregulloren për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të popullit dhe zëvendësve të Avokatit të Popullit.

Kalojmë në votimin tjetër – ***Rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2016***. Ju lutem, bëhuni gati për votim! Votojmë tash!

Zotërinj deputetë, zotërinj shefa të grupeve, zotërinj deputetë individualisht, e dini mirë sikurse unë, që të gjithë po votoni për, por nuk është ai numri, nuk është numri i cili... çfarë teknike? Atëherë, a dëshironi t'i votojmë për të arritur atë 61-sh, i cili është interpretim i hershëm. A doni sërish për votim?

Atëherë, keni kujdes, jemi duke votuar këtë të fundit njëherë e kthehemi atje. Domethënë, pikën 20, ***Rekomandimet e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2016***.

Votoni tash!

Atëherë, 62 kanë votuar, 59 janë për, 2 abstenim, 1 kundër. Kuvendi miratoi Rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Fondit të kursimeve pensionale të Kosovës për caktimin e taksës operationale 0,082% dhe taksës investive 0,398% për vitin 2016.

Atëherë, kthehemi te ***Projektligji për kundërvajtje***. Ju lutem shumë, i kishim 60 vota një herë, më pak herën tjetër, të gjitha për. Po e votojmë edhe një herë për Projektligjin për kundërvajtje. Votojmë tash!

Gjithsej 62 vota, të gjitha janë “kundër”, s’ka abstenim edhe... pra, nuk ka kundër dhe abstenim, janë 62 për. “Lapsus lingua” quhet gabimi në të folur, por shifrat janë brenda, që s’i luan topi.

Atëherë, i kryem të gjitha votimet. Jemi te pika njëzetënjë:

21. Zgjedhja e një anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Komisioni Funksional për Legjislacion ka zhvilluar procedurat për zgjedhjen e kandidatit për anëtar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar për votim kandidatët, si në vijim: Dragan Veljković dhe Nenad Lazić. Nënkryetarja e Komisionit, Selvije Halimi, e arsyeton raportin me rekomandime.

Ju lutem, veç edhe një moment, ju lutem për kujdes! Nëse ju pranoni, që t'i bëjmë të dy votimet, kemi edhe një votim tjetër, në mënyrë që ta racionalizojmë kohën, sepse e kemi edhe një seancë për pikën 4, për lexim të dytë.

Atëherë, me pëlqimin e Kuvendit do të bëjmë dy votime, një për një anëtar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe zgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Së pari, zonja Halimi e ka fjalën.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë dhe Kabinet qeveritar,

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në bazë të nenit 108, paragrafi 6, nënparagrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 5a të Ligjit 05/L-033 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës ka zhvilluar procedurat për përzgjedhjen e kandidatit për anëtar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe në mbledhjen e mbajtur më 11 dhjetor 2015 vendosi, që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

I rekomandohen Kuvendit për votim kandidatët për anëtar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, siç përcaktohet në nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 3 i Kushtetutës, të radhitur sipas rezultateve të poentimit si në vijim:

1. Dragan Veljković, 9,12; dhe
2. Nenad Lazić 7,53 pikë.

Kuvendi prej dy kandidatëve të propozuar për anëtar të Këshillit Gjyqësor do të zgjedhë njërin nga kandidatët. Votimi i kandidatëve për anëtarë të Këshillit Gjyqësor bëhet me votim të fshehtë. Mandati i anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës është 5 vjet.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni t'ua lexoj edhe procedurën e votimit. Lista duhet të përmbajë dy kandidatë. Kuvendi me votim të fshehtë zgjedh anëtarin e Këshillit Gjyqësor. Nëse, në rrethin e parë kandidatët e propozuar nga komisioni përkatës i Kuvendit nuk marrin shumicën e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, atëherë në rundin e dytë konsiderohet i zgjedhur kandidati me numrin më të madh të votave.

Kjo është sipas Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ndërsa, për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit. Fjalën e ka kryetarja e Komisionit ad hoc, Xhevahire Izmaqu.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së në bazë të neneve 67 dhe 71 të Rregullores së Kuvendit, si dhe të nenit 26 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës në

mbledhjen e mbajtur më datë 26.01.2016, pas shqyrtimit të biografive dhe intervistimit të kandidatëve për anëtarë të Bordit të RTK-së, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m:

I rekomandohet Kuvendit të Republikës së Kosovës të bëjë emërimin e dy anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës me votim të fshehtë. Për dy pozita për anëtarë të Bordit të RTK-së nga radhët e komunitetit shumicë shqiptarë, propozohen për votim 4 kandidatë, si në vijim:

1. Ismet Osdautaj,
2. Fadil Miftari,
3. Naim Gashi dhe
4. Naim Zeqiri.

Kuvendi bën përzgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit të RTK-së nga katër të propozuarit. Anëtarët e Bordit të RTK-së të emërohen me mandat 3-vjeçar. Kaq!

KRYESUESI: Faleminderit! Para se t'i propozomë komisionit, a ka në emër të grupeve dikush komente rreth këtyre, apo jo? Nuk ka.

Ju lutem, atëherë duhet t'i propozojmë nga një anëtar për Komisionin votues. Grupi i PDK-së, kush e do fjalën? Deputeti Reçica e ka fjalën.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryesues!
Grupi Parlamentar e propozon deputetin Hajdar Beqa.

KRYESUESI: Hajdar Beqaj. LDK, Ismet Beqiri propozon.

ISMET BEQIRI: Ne e propozojmë zotin Sali Morina.

KRYESUESI: Natyrisht, Sali Morina. "Vetëvendosje", s'ka. Aleanca, s'është. Lista serbe, kush propozon? Fikrim Damka për "6+".

FIKRIM DAMKA: Faleminderit, kryesues!
Për "6+" e propozoj Danush Ademin.

KRYESUESI: Lista serbe, një propozim? Jelena Bontiq.

JELENA BONTIĆ: Ja predlažem sebe, da ja budem član komisije. Nema nikog drugog.

KRYESUESI: E propozon vetveten, në rregull.
Atëherë, të gjithë anëtarët e komisionit, le të marrin në përkujdesje punën që kanë. I ftoj ta fillojnë punën?

(Ndërprerje e incizimit)

Edhe një herë deputetëve, ju lutem, kemi seancë tjetër pas këtyre votimeve, rrini! Kaq!

(Ndërprerje e incizimit)

Komisioni, është i gatshëm për punë? Po!

Avdyl Imeri, Bislim Zogaj, Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Azem Sylaj, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Besnik Bislimi, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Enver Hoxhaj, Etem Arifi, Fadil Beka, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gezim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontić, Kadri Veseli, Kujtim Paçaku, Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Latif Gashi, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Margarita Kadriu-Ukelli, Melihate Tërmkolli, Mexhide Mjaku-Topalli, Milazim Haliti, Milena Miliçević, Milka Vuletić, Mufera Serbica-Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emmini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Ramiz Kelmendi, Ramush Haradinaj, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Shala-Berisha, Sali Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavlević, Selvi Halimi, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukrije Bytyqi, Slavko Simić, Slobodan Petrović, Sergjan Popović, Synavere Rysha, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaili, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti.

(Ndërprerje e incizimit)

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Urdhëro, e ke fjalën për rezultatet përfundimtare.

JELENA BONTIĆ: Poštovani poslanici,

Nakon glasanja, komisija je došla do sledećih glasova. Za člana Sudskog saveta, prvi glas:

- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Nevažeca,
- Nenad Lazić,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Nenad Lazić,
- Nenad Lazić,
- Dragan Veljković,

- [illegible]

- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Nenad Lazić,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Nenad Lazić,
- Nenad Lazić,
- Dragan Veljković, i
- Nenad Lazić.

KRYETARI: Tani zoti Beqa do të na i lexojë edhe rezultatet nga votimi i dytë.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar!

Do t'i numërojmë votimet për zgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të RTK-së, për secilin kandidat.

- Naim Gashi, Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari, Naim Gashi,
- Ismet Osdautaj, Fadil Miftari,
- Naim Zeqiri,
- Naim Zeqiri,
- Ismet Osdautaj, Fadil Miftari,
- Naim Gashi, Naim Zeqiri,
- Ismet Osdautaj, Fadil Miftari,
- Naim Gashi, Naim Zeqiri,
- Naim Gashi, Naim Zeqiri,
- Ismet Osdautaj, Fadil Miftari,
- Ismet Osdautaj, Fadil Miftari,
- Ismet Osdautaj, Fadil Miftari,
- Naim Gashi, Naim Zeqiri,
- Ismet Osdautaj, Fadil Miftari,
- Ismet Osdautaj, Naim Gashi,
- Fadil Miftari, Naim Gashi,
- Naim Gashi, Naim Zeqiri,
- Naim Gashi, Naim Zeqiri,

- Fadil Miftari,
- Ismet Osdautaj, Naim Gashi,
- Fadil Miftari, Naim Gashi,
- Naim Gashi, Naim Zeqiri,
- Naim Gashi, Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari, Naim Gashi,
- Fadil Miftari, Naim zeqiri,
- Ismet osdautaj, Fadil Miftari,
- Naim Gashi, Naim Zeqiri,
- Naim Gashi, Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari, Naim Gashi,
- Naim Gashi, Naim Zeqiri,
- Ismet Osdautaj,
- Naim Gashi, Naim Zeqiri,
- Ismet Osdautaj,
- E pavlefshme,
- Naim Gashi, Naim Zeqiri,
- Ismet Osdautaj, Naim Gashi,
- Ismet Osdautaj, Fadil Miftari,
- Naim Gashi, Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari,
- Naim Gashi,
- Naim Zeqiri,
- E pavlefshme,
- Ismet Osdautaj, Fadil Miftari,
- Naim Gashi, Naim Zeqiri,
- Naim Gashi, Naim Zeqiri,
- Ismet Osdautaj, Naim Gashi,
- E pavlefshme,
- Naim Gashi,
- Fadil Miftari,
- Ismet Osdautaj, Fadil Miftari,
- Fadil Miftari, Naim zeqiri,
- Ismet Osdautaj, Naim Zeqiri,
- Naim Gashi, Naim zeqiri,
- Ismet Osdautaj, Fadil Miftari,
- Ismet Osdautaj, Naim Gashi,
- Fadil Miftari, Naim Zeqiri,
- Ismet Osdautaj, Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,
- Naim Gashi, Naim Zeqiri,
- Ismet Osdautaj,
- Fadil Miftari, Naim Gashi,
- Ismet Osdautaj, Naim Gashi,

- Naim Gashi, Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari, Naim Zeqiri,
- Naim Gashi, Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari, Naim Zeqiri,
- Ismet Osdaudaj, Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,
- Naim Gashi,
- Fadil Miftari, Naim Gashi, dhe
- Naim Gashi, Naim Zeqiri.

KRYETARI: Urdhëro, zoti Morina!

SALI MORINA: Faleminderit, kryetar!

Atëherë, për rezultatet e votimit për zgjedhjen e 1 anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Komisioni votues, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e 1 anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur me 19 shkurt 2016, konstaton se:

- Në këtë votim kanë marrë pjesë 74 deputetë,
- E pavlefshme ishte vetëm 1 votë.

Ndërsa, votat e fituara për kandidatët e propozuar, janë si vijon:

- Dragan Velković i ka fituar 57 vota, ndërsa
- Nenad Laziq i ka fituar 16 vota.

Prandaj, duhet të përsëritet procesi i votimit edhe një herë, sepse asnjëri prej kandidatëve nuk i ka fituar votat e mjaftueshme.

KRYETARI: Atëherë, tash janë rezultatet e votimit për RTK-në!

SALI MORINA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Për rezultatet e votimit për zgjedhjen e 2 anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, komisioni votues pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e 2 anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur me 19 shkurt 2016, konstaton:

- Në votim kanë marrë pjesë 74 deputetë,
- Të pavlefshme kanë qenë 2 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë si në vijim:

- Ismet Osdaudaj ka fituar 24 vota;
- Fadil Miftari ka fituar 32 vota;
- Naim Gashi i ka fituar 38 vota;
- Naim Zeqiri i ka fituar 32 vota.

Në bazë të rezultateve të votimit, në pajtim me nenin 65 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 26 të Ligjit Numër 04/L-46 për Radiotelevizionin e Kosovës dhe nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, konstatohet se:

- Naim Gashi zgjidhet anëtar i Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, ndërsa procesi i votimit për zgjedhjen e 1 anëtarit tjetër, përsëritet.

Në garë mbesin 2 kandidatët, të cilët kanë më shumë vota dhe do të thotë se mbetet në garë për anëtar të Bordit zoti Fadil Miftari dhe Naim Zeqiri, kurse zoti Ismet Osdaudaj, në bazë të rezultatit të votimit eliminohet nga procesi i votimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani përgatitemi për procesin e dytë të votimit. Le të jetë komisioni i njëjtë dhe të procedojë.

(Pauzë e shkurtër)

KRYETARI: Të nderuar deputetë, e ftoj komisionin që t'i zërë vendet e veta dhe fillojmë me procesin e votimit.

Kërkoj nga kryetarët e grupeve parlamentare që t'i thërrasin deputetët për të prezantuar në sallë dhe fillojmë me thirrjen e emrave të deputetëve:

Avdyl Imeri, Bislim Zogaj, Adem Grabovci, Adem Hoxha, Adem Salihaj, Agim Ademaj, Agim Aliu, Agim Çeku, Agim Kikaj, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Haxhiu, Ali Sadriu, Alma Lama, Anton Quni, Arben Gashi, Armend Zemaj, Azem Sylja, Bali Muharremaj, Bardhyl Meta, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Besim Beqaj, Besnik Bislimi, Blerim Grainca, Blerim Shala, Blerta Deliu-Kodra, Bojan Mitiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi, Daut Haradinaj, Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Duda Balje, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Enver Hoxhaj, Etem Arifi, Fadil Beka, Fadil Demaku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Faton Topalli, Fikrim Damka, Fisnik Ismajli, Flora Brovina, Ganimete Musliu, Gezim Kelmendi, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Hatim Baxhaku, Haxhi Shala, Ilir Deda, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivković, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Kujtim Paçaku, Labinotë Demi-Murtezi, Lahi Brahimaj, Latif Gashi, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Margarita Kadriu-Ukelli, Melihate Tërmkolli, Mexhide Mjaku-Topalli, Milazim Haliti, Milena Miliçević, Milka Vuletiq, Mufera Serbica-Shinik, Muhamet Mustafa, Murat Hoxha, Mytahir Haskuka, Naim Fetahu, Nait Hasani, Naser Osmani, Nenad Rashiq, Nezir Çoçaj, Njomza Emmini, Nuredin Ibishi, Nuredin Lushtaku, Pal Lekaj, Puhije Demaku, Rafet Rama, Raif Qela, Ramiz Kelmendi, Ramush Haradinaj, Rexhep Selimi, Rustem Berisha, Sabri Hamiti, Sadri Ferati, Safete Hadërgjonaj, Sala Shala-Berisha, Sali Morina, Salih Salihu, Salihe Mustafa, Sasha Milosavleviq, Selviqe Halimi, Shaip Muja, Shpejtim Bulliqi, Shqipe Pantina, Shukrije Bytyqi, Slavko Simiq, Slobodan Petroviq, Sergjan Popović, Synavere Rysha, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Teuta Sahatqija, Time Kadrijaj, Valdete Bajrami, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani, Xhavit Haliti, Xhevahire Izmaqi, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti.

(Vijon procedura e votimit)

KRYETARI: Atëherë, do të kisha lutur për vëmendje! Zini vendet të nderuar deputetë, sepse kemi paraqitjen e rezultatit të votimit.

JELENA BONTIĆ: Poštovani poslanici,
Komisija je završila sa uvidom glasanja za člana Sudskog saveta, kao što glasi:

- Dragan Veljković,
- Nenad Lazić,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Nenad Lazić,
- Nenad Lazić,
- Dragan Veljković,
- Nenad Lazić,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Nenad Lazić,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Nenad Lazić,
- Dragan Veljković,
- Nenad Lazić,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Nenad Lazić,
- Dragan Veljković,
- Nenad Lazić,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,
- Dragan Veljković,

- [illegible]

KRYETARI: Urdhëroni, zoti Morina!

SALI MORINA:Faleminderit, kryetar!

Të nderaur deputetë, po fillojmë me numërimin e dytë për zgjedhjen e 2 anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

- Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,
- Naim Zeqiri,
- Naim Zeqiri,

- Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,
- Naim Zeqiri,
- Naim Zeqiri,
- Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,
- Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,
- Naim Zeqiri,
- Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,
- Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari,
- E pavlefshme,
- Naim Zeqiri,
- E pavlefshme,
- Naim Zeqiri,
- Naim Zeqiri,
- Naim Zeqiri,
- Naim Zeqiri,
- Naim Zeqiri,
- Naim Zeqiri,
- Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,
- Naim Zeqiri,
- FadilMiftari,
- Fadil Miftari,
- Naim Zeqiri,
- Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,
- Naim Zeqiri,
- Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari,
- Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari,
- Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,
- E pavlefshme,
- Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,

- Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,
- Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari,
- Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,
- Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari,
- Naim Zeqiri,
- Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,
- Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,
- Naim Zeqiri,
- Fadil Miftari,
- Fadil Miftari,
- E pavlefshme,
- Fadil Miftari, dhe
- Naim Zeqiri.

(Ndërprerje e shkurtër - procedura e votimit)

KRYETARI: Urdhëroni, i nderuar Morina!

SALI MORINA: Faleminderit! Të nderuar kolegë deputetë,
Për rezultatet e votimit për zgjedhjen e 1 anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, komisioni votues, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e 1 anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen plenare, të mbajtur më 19 shkurt 2016, në rundin e dytë, konstaton:

- Në votim kanë marrë pjesë 75 deputetë,
- Të pavlefshme nuk ka pasur.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë, si në vijim:

- Dragan Velković ka fituar 59 vota, ndërsa
- Nenad Laziq, 16 vota.

Konstatohet se Dragan Velković zgjidhet anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me mandat 5-vjeçar.

Ndërsa për rezultatet e votimit për zgjedhjen e 2 anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, Komisioni votues pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për zgjedhjen e 2 anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës, në mbledhjen plenare, të mbajtur me 19 shkurt 2016, në rundin e dytë, konstaton se:

- Në votim kanë marrë pjesë 75 deputetë,
- të pavlefshme kanë qenë 3.
- Votat e fituara për kandidatët e propozuar janë si në vijim:
- Fadil Miftari ka fituar 41 vota,
- Naim Zeqiri ka fituar 31 vota.

Konstatohet se Fadil Miftari zgjidhet anëtar i Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës me mandat 3-vjeçar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit zoti Morina!

Deputetë të nderuar, ju njoftoj se shqyrtimi dhe votimi i pikave të mbetura të kësaj seance do të vazhdojë të mërkurën, më 24 shkurt 2016, në orën 14:00.

Mirupafshim në seancën e radhës, e cila do të mbahet menjëherë, në pajtim me vendimin e seancës së sotme plenare për shqyrtimin e dytë të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik të Republikës së Kosovës.

* * *

E mërkurë, 24 shkurt 2016
Vazhdimi i mbledhjes, e filluar më 19 shkurt
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

Vazhdimi i seancës plenare

KRYETARI: I nderuar zëvendëskryeministër dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 19 shkurt 2016.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm me prani fizike janë 86 deputetë. Kisha kërkuat që deputetët t'i aktivizojnë kartelat, për arsye se në mënyrë elektronike janë më pak. Konstatoj që janë plotësuar kushtet për punë.

Para se të procedojmë me vazhdimin e seancës, zonja Tërmkolli e ka kërkuar fjalën. Urdhëroni!

MELIHATE TËRMKOLLI: Faleminderit, zoti kryetar!
Të nderuar deputetë,
Ju lutem për durim vetëm një minutë. E kam një sqarim për ta bërë.

Dje në konferencë me gazetarë e kam paraqitur një deklaratë, apo qëndrimin tim nga pozita deputetes së Kuvendit të Kosovës.

Deklaratën e kam ndie si obligim timin, si një kontribut për një stabilizim politik dhe njëkohësisht si rol dinjitoz i përfaqësuesit të popullit në Parlament.

Fatkeqësisht, deklarata ime është censuruar dhe është deformuar skajshmërisht nga disa medie që ishin të pranishme në konferencë dhe nga disa që nuk ishin të pranishme.

Radiotelevizioni ynë i Kosovës, RTK-ja jonë e famshme, e dashur, u vu në ballë të kësaj maskarade. RTK-ja për të cilën ne votojmë për t'i dhënë para, për t'i mbajtur mbi 1 000 veta, 700 prej të cilëve nuk bëjnë asgjë, vihet në krye një maskarade të tillë politike.

Informatat që u dhanë për gjoja qëndrimin tim për president janë totalisht të pavërteta.

I thërras institucionet kompetente që të marrin masa ndaj këtyre medieve me tendenca vrastare. Vrasja nuk bëhet vetëm me plumba. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E vazhdojmë me seancën.

Edhe një herë, prania në mënyrë elektronike është 82 deputetë, derisa i kemi 86 deputetë. Katër deputetë nuk kanë kartelë, ta dimë për arsye të votimit.

5. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e rehabilitimit të rrugës hekurudhore 10

Ju njoftoj se diskutimet për këtë pikë dhe për pikat 6 dhe 7 kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 14 dhjetor 2015, por për mungesë të kuorumit nuk është proceduar me votimin e këtyre pikave.

Të nderuar deputetë,

Para se të vazhdojmë me votimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua, konstatoj se në sallë janë të pranishëm 85 deputetë, që është numër i mjaftueshëm për procedim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Një deputet nuk ka kartelë. Kush është? Po. Ok-ej! Atëherë, vota e saj do të futet në pjesën e votimit me dorë edhe në mënyrë fizike, i bashkëngjitet votimit elektronik.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Zonja deputete, cila është votimi yt? Ok-ej!

Atëherë i kemi 82 vota në mënyrë elektronike, plus deputetja e nderuar, 83 vota për, një abstenim dhe asnjë kundër.

Kuvendi e miratoi Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e rehabilitimit të rrugës hekurudhore 10.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

6. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2014 për projektin e Huas

Të nderuar deputetë,

Para se të vazhdojmë me votimin e Projektligjit për ratifikimin e kësaj marrëveshjeje, konstatoj se në sallë janë të pranishëm 86 deputetë në mënyrë elektronike.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se 85 deputetë kanë marrë pjesë në votim, 84 kanë votuar për, një abstenim, asnjë kundër.

Kuvendi e miratoi Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2014 për projektin e Huas.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

7. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë Kosovë - UniCredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në QKUK

Të nderuar deputetë,

Para se të vazhdojmë me votimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes, konstatoj se në sallë janë të pranishëm 86 deputetë, që është numër i mjaftueshëm për procedim. Një deputet e ka kërkuar fjalën. Zoti Haxhiu, urdhëro!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe në seancën paraprake të vitit të kaluar kur kemi debatuar për këtë pikë të rendit të ditës, fillimisht dua ta falënderoj Qeverinë Austriake dhe Bankën Austriake për lejimin e kësaj kredie me qëllimin më të mirë për përmirësimin e gjendjes në shëndetësi, në veçanti në prioritetet që ka shëndetësia kosovare.

Tani një vit e gjysmë kjo marrëveshje po sillet nëpër Kuvend dhe nëpër zyra, mund të themi lirisht më tepër në Ministrinë e Shëndetësisë për arsye të një joseriozitetit dhe një qasje të mirëfilltë të kësaj ministrie sa i përket kësaj kredie.

Ajo çka ka ndodhur brenda kësaj periudhe kohore është një ndryshim total i projektit dhe i destinacionit që Banka Austriake dhe vetë Qeveria Austriake e ka projektuar për Qeverinë e Kosovës dhe për shëndetësinë kosovare.

Kam ngrehur dyshimet e mia herën e fundit për rritjen e kredisë për 500 mijë euro, por ministri nuk ka qenë i pranishëm në atë seancë. Prandaj, duke e pasur parasysh praninë e ministrit sot këtu, vërtet është në interesin e qytetarëve të dihet se përse kredia e Bankës Austriake është ngritur për 500 mijë euro. Besoj që arsyetimin që e kanë dhënë mediet publike nga ministri Rrahmani nuk qëndron për arsye se është ‘non sens’ të shpenzohen 500 mijë euro për lyerje dhe për meremetim të një hapësire prej 150 metrave katrorë.

Prandaj, do të ishte mirë që kjo të sqarohej, edhe pse po blejmë aparaturë në një sektor ku po e dublifikojmë aparaturën dhe kjo nuk do të duhej të ishte prioritet i Ministrisë së Shëndetësisë. Prioritetet Ministrisë së Shëndetësisë janë tjera, prandaj edhe kam kërkuar më herët shkarkimin e këtij ministri për arsye se ende nuk i ka kuptuar ato prioritete dhe po vazhdon ende të mos i kuptoj ato, e uroj që në të ardhmen vërtet të ketë një qasje më të mirë sa u përket problemeve, në veçanti në këtë sektor dhe në veçanti në Sektorin e Kardiologjisë, ku mungesat janë kryesisht në furnizime, e jo në aparaturë, që pacientët tanë mos të vuajnë ende nga këto sëmundje. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë Shqip Muja e ka kërkuar fjalën. Në fund, ministri i Shëndetësisë do ta marrë fjalën.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Meqenëse ky angazhim është kontestuar me kontestim të bazuar, pa dashur ta anashkaloj ndihmën e kredisë që jepet nga shteti austriak për ta zhvilluar shëndetësinë në Republikën e Kosovës, unë e përkrah plotësisht angazhimin e deputetëve që ta kontestojnë këtë dhe herën e kaluar kam thënë që Komisioni për Shëndetësi ta ngrejë një komision verifikues të vlerës komplet të tenderimit. Është specifikimi teknik të cilin e posedojmë dhe i cili na ka ardhur si informacion në rrugë të tjera, por jo zyrtare, me specifikim të detajuar dhe vlera e kredisë është vetëm 50% e vlerës reale.

Prandaj, nëse ne e kemi bërë ndonjë informim të gabuar është mirë që nëpërmjet një komisioni hetimor dhe tani që e kemi miratuar edhe prokurimin elektronik mund të jemi shumë transparentë që të riprogramohet kjo kredi, e cila ka kohë deri në fund të vitit 2016. Ndërsa, për çështjen e keqpërdorimit të votave të ministrit, i cili në medie më ka ra ta dëgjoj kur e kontestua që jo ligjërisht ne votuam herën e kaluar që Qendrës Klinike Universitare, apo Shërbimit Spitalor Universitar iu morën financat, deklaroi në media, tha “me votat e deputetëve, ata votuan, unë vetëm propozova”.

Prandaj, këta ministra na bëjnë ne të gabojmë për ta marrë forcën politike me votë dhe ta marrin mbrojtjen e tyre juridike me gabimet që ne bëjmë. Dhe, nëse vërtet janë mënyrat e tilla, unë propozoj që ta rristrukojmë dhe ta ridizanojmë këtë Qeveri, përndryshe u bëjmë ‘horë’. Faleminderit!

KRYETARI: Adem Grabovci, shef i grupit parlamentar e ka kërkuar fjalën, e pastaj ministri.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar këtë marrëveshje, e kemi analizuar dhe kemi ardhur në përfundim se investimet janë, jo të nevojshme, por të domosdoshme që t’i kemi në vendin tonë, e aq më tepër bëhet fjalë për sektorin e shëndetësisë.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike i ka dhënë mbështetje, prandaj edhe sot këtu i bëj thirrje këtij grupi që të votojë për këtë marrëveshje.

KRYETARI: Faleminderit! Ministri e ka fjalën, e ju qartësojuni në qoftë se ka ndonjë keqkuptim, pastaj shkojmë në votim.

MINISTRI IMET RRAHMANI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuari kryeministër,

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Është e vërtetë që s’kam qenë në seancën kur është ngrehur kjo çështje, por unë sot jam i gatshëm që në mënyrë kronologjike të jua jap sqarimet e duhura rreth marrëveshjes.

Marrëveshja për kredi të butë ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Bankës Qendrore të Austrisë në lartësi prej 20 milionë euro është arritur në vitin 2012. Domethënë, s’kemi të bëjmë këtu me një vit e gjysmë, por është çështja që tash po hyn në vitin e katërt. Sipas marrëveshjes, kredia është dashur të shpenzohet brenda tre vjetëve, ndërsa nëse nuk shfrytëzohet atëherë nga viti 2015

kredia do të duhej të figuronte si pjesë e buxhetit të ministrive përkatëse. Edhe Ministria e Shëndetësisë e ka pasur pjesën e vet.

Nga kredia e përgjithshme, 4,6 milionë janë dedikuar për projektet e shëndetësisë dhe kanë mundur të shfrytëzohen në tërësi në periudhën 2012-2014. Në vitin 2014 janë kryer procedurat për kontraktimin e dhomës hibride për shërbimin e kardiokirurgjisë në lartësi prej 4,6 milionë. Këto procedura nuk kanë përfunduar dhe në fund të vitit 2014 është hequr dorë nga ky projekt, sepse është vlerësuar nga ekspertët si i paarsyeshëm në këtë fazë.

Këtu diku kah maji, edhe zoti Haxhiu e ka thënë të njëjtën që e thashë edhe unë, e tash e paska ndërruar. S'e di pse. Bazuar në marrëveshjen kornizë ndërmjet Qeverisë dhe Bankës Qendrore të Austrisë, për shkak se buxheti nuk është shfrytëzuar sipas planit, në vitin 2015 me Ligjin e buxhetit janë bartur në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar 2,6 milionë për shfrytëzim, e 2 milionë kanë mbetur për çështje tjera dhe është hequr dorë nga dhoma hibride.

Me kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë në qershor 2015, me ndryshim të Ligjit të buxhetit 2,6 milionë janë bartur në Ministrinë e Shëndetësisë. Për shkak të kohës së shkurtër, Ministria e Shëndetësisë i ka intensifikuar aktivitetet për realizimin e projektit. Fillimisht Ministrisë së Financave i është kërkuar ta njoftojë Ministrinë e Jashtme të Austrisë për interesin tonë për ndryshim të projektit. Pas pajtimit për ndryshim, Ministria e Shëndetësisë gjithnjë sipas marrëveshjes, e ka autorizuar Agjencinë Austriake për Shëndetësi dhe Inxhiniering për realizimin e procedurave të prokurimit.

Në ndërkohë, nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës është pranuar lista e pajisjeve të propozuara për furnizim. Pas shqyrtimit të përbashkët me kryesuesin e bordit, drejtuesit e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës, me drejtorin e përgjithshëm dhe me drejtorin e Klinikës së Kardiologjisë, është arritur pajtueshmëria që të modernizohet Shërbimi i Kardiologjisë Invazive si parakusht për funksionalizimin e shërbimit të Kardiokirurgjisë.

Lista e dakorduar i është dërguar Agjencisë austriake për procedim të procedurave të prokurimit. Gjatë fazës përgatitore të procedurave të prokurimit, sipas rekomandimeve të Agjencisë Austriake për Inxhiniering dhe Shëndetësi, njëra nga kompanitë e interesuara e ka vizituar Qendrën Klinike Universitare të Kosovës për ta realizuar vlerësimin e kushteve për instalim, kushtet ambientale dhe shkallën e përllogaritur për shfrytëzim të më pastajmë të pajisjeve që do të blihen.

Të gjitha procedurat e prokurimit janë realizuar nga Agjencia Austriake për Shëndetësi dhe Inxhiniering në Vjenë, ndërsa Ministria e Shëndetësisë ka qenë vetëm si vëzhguese në procesin final të ofertave. Agjencia Austriake për Inxhiniering dhe Shëndetësi, pas shqyrtimit të të gjitha ofertave ka propozuar për dhënie të kontratës kompanisë "Vamed", e cila, përpos ofertës më të volitshme në lartësi prej 2,1 milionë euro, kishte ofruar edhe propozim shtesë për garanci, sigurim të mirëmbajtjes dhe servisimit për 24 muaj, renovim të hapësirave në shërbimin e kardiologjisë dhe izolimin nga rrezatimi, si dhe trajnimin e personelit të shërbimit për dy javë në Austri.

Meqë propozim-oferta shtesë është bërë në ditën e vlerësimit të tenderit nga përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, nga Agjencia Austriake për Inxhiniering është kërkuar shpjegim zyrtar për bazën ligjore të kësaj shtese prej 500 mijë eurove. Nga Agjencia Austriake për Inxhiniering është dërguar shpjegimi se kjo është çështje e cila mund të negociohet ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe operatorit fitues “Vamed”.

Në presion të kohës për shkak të vizitës së planifikuar atëherë të kryetarit të Austrisë, gjatë së cilës vizitë ishte planifikuar nënshkrimi i kontratës, në funksion të sigurimit të bazës ligjore për pjesën shtesë, të ofruar nga “Vamed”, jemi dakorduar që me një nen të veçantë të specifikohet që oferta shtesë paraprakisht do t’i nënshtrohet edhe një herë verifikimit ligjor dhe vetëm pas verifikimit të bazës ligjore të mund të zbatohet.

Unë ju them këtu tash se ne në rrugë zyrtare, e kemi dërguar kontratën në fjalë në Komisionin Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe besoj se të gjithë kanë pasur mundësi ta marrin zyrtarisht, e jo në rrugët e tjera.

Kontrata e tërësishme kap vlerën 2,6 milionë dhe do të shpenzohet vetëm buxheti prej 2,1 milionë euro për pajisje, ndërsa mbetja tjetër do të shpenzohet vetëm pas verifikimit ligjor. Në të kundërtën, do të shpenzohet vetëm pas procesit të ritenderimit për servisim dhe mirëmbajtje të pajisjeve dhe përgatitjes së hapësirave për vendosje të pajisjeve.

Duhet theksuar se sipas marrëveshjes të gjitha kontratat shpenzuese duhet të realizohen me kompaninë me origjinë nga Austria dhe kjo na detyron dhe na kufizon në përzgjedhjen e operatorëve. Gjithashtu, dua të them se me rrugë zyrtare i kemi dërguar të gjitha dokumentacionet ose kërkesat e donatorëve edhe shpjegimin ligjor se pse është dashur që një pjesë e buxhetit nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës të kthehet në Ministrinë e Shëndetësisë, respektivisht në AFSH. Kush ka dashur t’i shohë ato dokumente, i ka zyrtarisht të ofruara nga ne. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër!

Tash reagimet janë marrë vesh. Më tepër, në mënyrë kolegiale ju mund t’i trajtoni. I keni 20 sekonda Shaip edhe Bekim, ju lutem, se po futemi në votim.

Shaip e ke fjalën se je i pavarur, pastaj Bekimi. Urdhëro!

SHAIP MUJA: Zoti ministër!

Një procedurë e një vendimi të Këshillit të Ministrave duhet të zhvlerësohet në Këshillin e Ministrave e të vijë si propozim i ri në Parlament. Ajo procedurë nuk është aplikuar për Shërbimin Spitalor, prandaj këtu është shkelja ligjore, që po e them unë.

Pyetja tjetër për çështje...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Bekim, të lutem shpejt edhe ti.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryetar!

Vetëm dua ta sqaroj ministrin që kur vitin e kaluar kam kundërshtuar, ka qenë arsyeja ime që kam thënë që nuk është prioritet modernizimi dhe salla hibride, dhe pas një viti ministri të njëjtën gjë po e thotë. E ka ndryshuar projektin dhe e ka sjellë një projekt tjetër, që është dublifim i aparaturës. Dhe, sot po...

KRYETARI: Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim! Votojmë tash!

Nuk ka kaluar, veç ta jap rezultatin. Ta jap zyrtarisht rezultatin. 76 vota janë për, 1 është kundër, 6 abstenime.

A votojmë edhe një herë, pra? Regjia, përgatitemi edhe një herë për votim për të njëjtën marrëveshje. Jemi te votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë Kosovë - UniCredit Bank Austria AG. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Edhe një herë, jemi 83 deputetë, kanë votuar 78 për, 5 janë abstenime.

Pavarësisht kësaj, një votë nuk ndikon. Dëshironi edhe një herë? Një u avullua, ishte kundër...

A votojmë edhe një herë? Votojmë edhe një herë. Ju lutem për mirëkuptim! Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Ju lutem deputetë, votojmë tash!

Tani janë vetëm 76 për, 5 abstenime, gjithsej 81 deputetë e kanë dhënë votën. Konstatohet se Kuvendi nuk e miratoi Ligjin Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë Kosovë - UniCredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në QKUK.

8. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e Projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar raportin me rekomandime, si dhe amendamentet për miratim.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Abdullah Hoti. Atëherë, ministri i Arsimit, që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Urdhëroni, zoti Bajrami!

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar kolegë ministra,

Të nderuar deputetë,

Në vazhden e bashkëpunimit me partnerë ndërkombëtarë dhe me qëllim të përmbushjes së prioriteteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, pas përfundimit të të gjitha procedurave për marrjen e kredisë, e kemi nënshkruar marrëveshjen me Bankën Botërore për huamarrje për projektin "Përmirësimi i sistemit të arsimit në Kosovë".

Sistemi i arsimit në Kosovë përbën një sektor kyç, i cili kërkon investime të vazhdueshme për avancimin dhe përmirësimin e mëtejshëm të sistemit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, gjë që reflektohet direkt në avancimin e karrierës për të rinjtë e Kosovës. Kredia në fjalë e ka vlerën prej 11 milionë dollarë me normë interesi prej 1,25% me pesë vjet “greis periudhë” dhe plan kthimi për 20 vjet me këste që do të paguheshin dy herë në vit, më 15 prill dhe 15 tetor.

Projekti që do të financohet me këtë kredi ka për qëllim forcimin e sistemeve të përzgjedhura që kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë, llogaridhënies dhe efikasitetit në arsim në Republikën e Kosovës dhe është organizuar në tre komponentë:

1. Përmirësimi i planifikimit strategjik, menaxhimi i financave, monitorimi i vendimmarrjes. Ky komponent ka për qëllim forcimin e kapaciteteve të planifikimit strategjik dhe menaxhimit të financave në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, drejtoritë komunale të arsimit, shkollat dhe universitetet, me qëllim të përmirësimit të efikasitetit në shpenzime dhe rritjes së llogaridhënies.

2. Forcimi i kapaciteteve menaxhuese dhe i llogaridhënies për përmirësimin e cilësisë në arsim. Objektivi i këtij komponenti është të mbështetet dhe institucionalizohet sistemi i karrierës së mësimdhënësve, si dhe të lehtësohet shfrytëzimi i praktikave më të mira ndërkombëtare në vlerësimin e cilësisë në mësim.

3. Mbështetja për zbatimin e projektit për komunikim dhe objektivi i këtij komuniteti është ofrimi i mbështetjes adekuate për zbatimin e projektit.

Marrëveshja e kredisë për këtë projekt është arritur konform planifikimit buxhetor dhe në përputhje me dispozitat dhe strategjitë e borxhit publik, si dhe Ligjit për marrëveshje ndërkombëtare, andaj ju ftoj që ta përkrahni me votën tuaj.

Më lejoni me këtë rast ta falënderoj Bankën Botërore për mbështetje të vazhdueshme në arritjen e objektivave të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të cilat si qëllim kryesor e kanë përmirësimin e jetës së qytetarëve të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër! Tani radhën për diskutim e ka kryetari i Komisionit Funkcional, zoti Naser Osmani, për arsyetimin e raportit dhe t’i japë rekomandimet.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kolegë deputetë,

Projektligji për ratifikimin e Marrëveshjes për financimin ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e Projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit ka për qëllim që të ndikojë në zhvillimin, përmirësimin e cilësisë legjislative dhe efikasitetin në sistemin e arsimit në Republikën e Kosovës.

Implementues i kësaj marrëveshjeje është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ku janë specifikuar edhe kushtet e veçanta, që duhet t’i përmbush kjo ministri për implementimin e marrëveshjes. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, Republika e Kosovës merr një kredi në shumë të

kundërvlefshme në vlerë prej 7 900 000 të drejta speciale të tërheqjes, apo shprehur në euro, zbatimi i kësaj marrëveshjeje kap vlerën prej 6 300 000 euro.

Datat e kthimit të kredisë fillojnë nga viti 2020 deri në vitin 2040. Domethënë, kemi të bëjmë me një kredi 20-vjeçare. Shuma e kryegjësë së kredisë për pagesë në periudhën e kthimit prej vitit 2020 deri në vitin 2030 është 1,65%, ndërsa në periudhën tjetër prej vitit 2030 deri në vitin 2040 është 3,35%.

Kostoja buxhetore për kthimin e kredisë është trajtuar nga ministria sponsorizuese dhe Ministria e Financave dhe është pjesë e kornizës afatmesme buxhetore.

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka vlerësuar rëndësinë e marrëveshjes dhe kushteve të saj për financimin e Projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit dhe, meqë kostoja buxhetore është pjesë e kornizës afatmesme buxhetore, i kemi rekomanduar Kuvendit që ta aprovojë duke pasur parasysh edhe dy përmirësime teknike që i kemi bërë në ligjin ekzistues. Domethënë, kemi dy amendamente të cilat duhet të votohen, para se të votohet ligji në tërësi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Osmani! Tani është radha e grupeve parlamentare. S'ka deklaram. A ka prej ndonjë grupi? Nuk ka, po shoh reagimet. Deputetë? Nuk ka. Përfaqësuesi i Qeverisë? Nuk ka fjalë.

Atëherë, edhe për këtë marrëveshje duhen 2/3-at e votave të të gjithë deputetëve, pra së paku 80 vota. Votojmë për amendamentet e propozuara. Janë dy amendamente.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Të nderuar deputetë, tani e votojmë projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se në votim kanë marrë pjesë 83 deputetë, 82 për, 1 abstenim dhe Kuvendi e miratoi Ligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit.

- Propozimi i Grupit Parlamentar “6+” për zëvendësimin e kryetarit në Komisionin Parlamentar

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar “6+” e ka propozuar zëvendësimin e kryetarit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor. Në vend të Fikrim Damkës propozohet Duda Balje.

Kërkoj nga ju që nëpërmjet një votimi me ngritje dore të deklaroheni formalisht për propozimin e Grupit Parlamentar “6+”. Me shumicë absolute, konstatoj se Kuvendi e miratoi propozimin e Grupit Parlamentar “6+” për zëvendësimin e kryetarit të komisionit. Urime!

9. Votimi i propozimit të amendamentit nr. 25 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i proceduar nga Qeveria e Republikës së Kosovës

Ju njoftoj se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 14 dhjetor 2015, ndërsa në seancën e mbajtur më 17 dhjetor 2015 kishte mungesë të kuorumit, andaj procedimi me votim do të bëhet në seancën e sotme.

Ta marrim vetëm praninë fizike. Sa deputetë jemi në sallë? Në mënyrë elektronike jemi 85, ndërsa në sallë janë 83 deputetë, që nënkupton plotësimin e kushteve për votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim të amendamentit.

E votojmë në mënyrë elektronike amendamentin nr. 25. Votojmë tash!

Realisht, me procedura do të duhej të presim, por pas këtij votimi siç është, absolut, 80 janë për, 1 abstenim, nga 81 vota, nga komuniteti 19 deputetë kanë votuar për.

Atëherë, të nderuar deputetë, konstatoj se Kuvendi e miratoi amendamentin nr. 25 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ndryshimet e Kushtetutës hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës, neni 124, paragrafi 4 i Kushtetutës. Faleminderit!

Jemi në pikën e radhës:

17. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për standardizimin

Me kërkesë së zonjës ministre, ajo ka kërkuar që të shtyhet ky raportim. Atëherë, shtyhet për mbledhjen e radhës.

Jemi në pikën e radhës:

18. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë

Komisioni përkatës e ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

E ftoj raportuesin e Komisionit për Punë të Brendshme, zotin Nuredin Ibishi, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

NUREDIN IBISHI: ...mbikëqyrje të FSK-së, në bazë të nenit 73 të Rregullores së Kuvendit, lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-076, të miratuar më 23.1.2012, ku në mbledhjen e mbajtur më 22 dhjetor vendosi dhe pas të gjeturave i miraton 17 rekomandime dhe si të tilla i propozohet Kuvendit që t'i miratojë dhe në afatin gjashtëmujor të shikohet mbikëqyrja e zbatimit të rekomandimeve nga institucionet e Ministrisë së Brendshme, të Policisë, dhe të agjencive tjera të Ministrisë së Brendshme.

KRYETARI: Kërkoj falje, por pasi u vërejt publikisht, i shprehim përkrahje ministrit Memli Krasniqi dhe zëvendësministrit, zotit Bajram Geci në këto situata që nuk ishin të lehta. Zakonisht, s'ka qenë në traditën tonë të preket familja, por dikush ka rrëshqitur krejt.

Vazhdojmë me seancën. Tani është radha e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, nëse e duan fjalën.

Nuk e duan fjalën. As përfaqësuesit e Qeverisë, e as deputet nuk kemi për deklaram.

Të nderuar deputetë, vazhdojmë me votimin e raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Në votim kanë marrë pjesë 71 deputetë dhe të gjithë kanë votuar për.

Pra, konstatoj se Kuvendi e miratoi raportin me rekomandimet e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë.

Jemi në pikën e fundit të rendit të ditës:

19. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor lidhur me zbatimin e Ligjit për Inspektoratin Bujqësor

Komisioni përkatës e ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Bujqësor dhe Kuvendit ia ka paraqitur raportin me rekomandime.

Fjalën e ka raportuesi i Komisionit për Bujqësi, deputeti Adem Salihaj, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ADEM SALIHAI: Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, duke u bazuar në përgjegjësitë e tij, në bazë të nenit 73 të Rregullores së Kuvendit ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Bujqësor.

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, në mbledhjen e mbajtur më 29 janar 2016, pasi e shqyrtoi procesin e mbikëqyrjes së zbatimit të këtij ligji, vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këto rekomandime:

1. Qeveria të fillojë procedurën e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Inspektoratin Bujqësor, duke evituar konfliktin e përgjegjësi, duke ndarë e definuar qartë organizimin dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve që merren me zbatimin e tij, përfshirë këtu Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinës, Agjencinë Pyjore të Kosovës, komunat dhe eventalisht ndonjë institucion tjetër, i cili do të mund të përfshihej në këtë ligj.
2. Qeveria t'i hartojë urgjentisht 4 aktet nënligjore sipas neneve 11, 19, 23, 28 dhe 30 të Ligjit për Inspektoratin Bujqësor, të cilat do të zbatohen deri në miratimin nga Kuvendi të plotësimit dhe ndryshimit të këtij ligji, apo deri sa të hartohet një ligj i veçantë për Inspektoratin.
3. Qeveria ta shikojë mundësinë e ndarjes së mjeteve më të mëdha buxhetore me qëllim të kompletimit me kuadro dhe logjistikë të këtij segmenti të rëndësishëm të shtetit në të gjitha nivelet ku ai është paraparë me ligj.
4. Deri në ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Inspektoratin Bujqësor të bëhet një mbikëqyrje më e madhe e Qeverisë ndaj të gjitha institucioneve që merren me zbatimin e tij.
5. Qeveria t'i raportojë Kuvendit në afatin prej 3 muajsh lidhur me zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor propozon që ta aprovoni këtë raport me rekomandimet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani përfaqësuesit e grupeve e kanë radhën. A e do dikush fjalën? Emilija Rexhepi, nga Partia Demokratike të Kosovës, e ka kërkuar fjalën.

EMILIJÀ REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedniče!

Parlamentarna grupa PDK-a je razmotrila Izveštaj Komisije za poljoprivredu i ruralni razvoj, koji su članovi te Funkcionalne komisije tokom obilaska i posjeta opštinama uradili na terenu sa bitnim i jako važnim preporukama koje se odnose na sprovođenje Zakona 03/L-029 o Poljoprivrednom inspektoratu, te ustanovila da postoji veliki problem mešanja kompetencija od strane centralnog i lokalnog nivoa, te nesprovođenja ovog zakona u celosti, što predstavlja veliki problem za naše društvo.

Po nama, preporuke koje je Komisija danas dostavila Parlamentu, a odnose na sve poteškoće i izazove sa kojima se lokalni inspektori, ali i inspektori ministarstva suočavaju na terenu, ali i lakše implementacije ovog zakona, odnose se da: Vlada mora početi sa procedurom izmene i dopune Zakona broj 03/L-029 o Poljoprivrednom inspektorijatu, eliminirajući konflikt odgovornosti, jasno definišući organizovanje i odgovornosti svih institucija koje se bave njegovim sprovođenjem, uključujući posebno Agenciju za veterinarstvo, Agenciju za šume Kosova, opštine i druge institucije koje će biti obuhvaćene ovim zakonom.

Zatim, jako bitna stavka je da Vlada hitno izradi 4 podzakonska akta prema članovima 12, 19, 23, 28 i 38 Zakona 03/L-29 o Poljoprivrednom inspektoratu, koji će sprovoziti do usvajanja od strane Skupštine, kako bi se na pravilan način obavila izmena i dopuna ovog zakona, ili postoji mogućnost i izrade jednog posebnog zakona o inspekciji.

Jako važna stavka je da Vlada, odnosno Ministarstvo financija razmotri mogućnost podele većih budžetskih sredstava u cilju kompletiranja kadrova i logistikom ovog važnog segmenta države na svim nivoima - i lokalnim i centralnim, ali da Vlada izveštava Skupštinu o vremenskom periodu od svakih 3 meseca kako ide implementacija, odnosno sprovođenje ovog zakona na terenu sa svim preporukama koje ćemo danas ovde usvojiti.

Poslanici Parlamentarne grupe PDK-a će glasati za preporuke koje Funkcionalna komisija za poljoprivredu danas dostavila Parlamentu, i nadam se da će i druge parlamentarne grupe to podržati i usvojiti. Zahvaljujem!

KRYETARI: Faleminderit zonja deputete! E do edhe dikush tjetër fjalën?
Atëherë, të nderuar deputetë, vazhdojmë me votimin e raportit me rekomandimet e Komisionit përkatës për mbikëqyrjen e Ligjit për Inspektoratin Bujqësor.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Atëherë, konstatoj se me 72 vota për, 1 abstenim dhe 1 kundër, Kuvendi e miratoi raportin me rekomandimet e Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Bujqësor.

Të nderuar deputetë,

Me këtë i mbylлим punimet e seancës së sotme plenare. Faleminderit dhe mirupafshim në seancën e radhës!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*